


Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë



Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë

Basil Schader

Nexhat Maloku

Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

1

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» (MGJP; në Zvicër GJKA: Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut); Nxitje didaktike 1.

Botuar nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike.



Udhëheqës i projektit:	Basil Schader
Autori:	Basil Schader, Prof. Dr. Dr., didakt i gjuhës në SHLP (PH Zürich) në Cyrih, ekspert për didaktikën ndërkulturore, autor tekstesh mësimore
Redaktimi nga ana e MGJP:	Nexhat Maloku, M.A., mësues i GJKA, kryetar i Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë «N. Frashëri» në Zvicër
Mësuesit/et provues/e:	Nexhat Maloku, Cyrih (GJKA shqip) Sakine Koç, Cyrih (GJKA turqisht) Bozena Alebic, Cyrih (GJKA kroatisht) Elisa Aeschmann-Ferreira dhe Raquel Rocha (GJKA portugalisht) Hazir Mehmeti, Vjenë Rifat Hamiti, Dyseldorf
Ilustrimet, koncepti i përgjithshëm pamor dhe realizimi:	Barbara Müller, Erlenbach
Përkthimi:	Nexhat Maloku, M.A.
Lektorati:	Arif Demolli
Shtypi:	Shtypshkronja Printing Press, Prishtina/Kosova

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» u mundësua me përkrahjen e Entit Federal për Kulturë (BAK).



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Departement des Innern EDI
Bundesamt für Kultur BAK

Ky projekt u financua pjesërisht me përkrahje të Komisionit Evropian. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij botimi e bartin vetë hartuesit/et; Komisioni nuk merr përgjegjësinë për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të përmbajtjes.



Lifelong
Learning
Programme

Numri ISBN i botimit përkatës gjermanisht:	ISBN 978-3-280-04118-5
--	------------------------

Pasqyra e përmbajtjes

Parafjalë për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

7

Hyrje

- | | | |
|---|---|----|
| 1 | Të shkruarit në gjuhën e prejardhjes: jo i thjeshtë, por me rëndësi | 8 |
| 2 | Objektivat dhe mbarështrimi i kësaj fletoreje | 8 |
| 3 | Pikat thelbësore të didaktikës aktuale në të shkruarit e tekstit | 8 |
| 4 | Pika plotësuese në lidhje speciale me shkrimin e teksteve në kuadër të mëimit në gjuhën e prejardhjes | 10 |
| 5 | Për dhënien e notave dhe vlerësimin e punës në të shkruar: pika të rëndësishme | 11 |

I Për të filluar: shembuj të të shkruarit të nivelit të ulët dhe aktivitete për përkrahjen e motivimit

- | | | |
|---|--|----|
| 1 | Ushtrim paraprak: të rrëfihen bashkërisht tregime sipas radhës, vazhduese, ose tregime zinxhir | 14 |
| 2 | Të shkruarit bashkërisht: tregime radhe, vazhduese, zinxhir ose palosëse | 15 |
| 3 | Tregime dypikëshe, tregime me fjalë «kapëse», me fjalë dëshirash dhe tregime kush-ku-çka | 16 |
| 4 | Tregime skelë, tregime fjalënxitëse, tregime strukturë | 17 |
| 5 | Të shkruarit sipas fantazisë në forma të ndryshme sociale | 18 |
| 6 | Detyra të vogla modeluese dhe kreative me gjuhë | 19 |
| 7 | Gjëegjëza me gjuhë | 20 |

II Teknikat dhe strategjitë për fazat e ndryshme të procesit të të shkruarit

- | | | |
|----|---|----|
| 8 | Të gjenden idetë, ndërtimi i tekstit të parastrukturohet | 24 |
| 9 | Të planifikohet ndërtimi i tekstit | 25 |
| 10 | Teksti të ndahet dhe modelohet me tituj, mestituj dhe pjesë | 27 |

11	Teknikat për përpunim dhe vetkorrekturë	28
12	Të shkruhet me adresë referimi; tekstet të modelohen bukur dhe të prezentohen	30
13	Komenti për fletët e punës të nxënësve/eve FP 1 + 2	31
FP1	Një tekst të planifikohet, përmbledhet, përpunohet - hap pas hapi	33
FP2	Sjellja me problemet në të shkruar	35

III

Nxitje për përkrahjen e aspekteve të pjesshme të të shkruarit

14	Nxitje për punë në leksik I: punë me fushat e fjalëve, vënia gati e mjeteve të zgjeruara gjuhësore	38
15	Nxitje për punë në leksik II: punë me tekste me zbrazësira, prova rezervë etj.	40
16	Nxitje lidhur me ndërtimin e tekstit dhe ndarjen e tij	43
17	Nxitje për punë në stil I: ushtrimi i stilit veprues dhe zbulues	45
18	Nxitje për punë në stil II: të shkruhet saktë/ të paraqitet bukur dhe interesant	48
19	Udhëzime për përmirësimin e sintaksës dhe morfologjisë	51

IV

Ide për kontekste të caktuara të të shkruarit

20	Situata të të shkruarit, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për mësimin në gjuhën e prejardhjes	54
21	Projekte, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për bashkëpunimin me mësimin e rregullt	57
22	Projekte modeluese muzikore - kreative me gjuhë	59

Literatura e përdorur

61

Sqarimet, shkurtesat

Gjuha e parë: Edhe gjuhë amtare – ose familjare:
gjuha të cilën një fëmijë e ka mësuar dhe folur
si gjuhë të parë në shtëpi. Mjaft fëmijë kanë dy
gjuhë.

Gjuha shkollore: Gjuha e cila flitet në shkollën e vendit emigrues.
Gjithashtu mund të vijë edhe dialekti lokal si
gjuhë e rrethit

Shkurtesat: N = Nxënës, nxënëse
M = Mësues, mësuese

Legjenda

për të dhënat për formën sociale, klasën dhe kohën e nevojshme tek
propozimet mësimore:



PI = Punë individuale



PP = Punë me partner



GV = Grup i vogël



TK = Tërë klasa

kl. 1–9

E përshtatshme për klasat ... deri ... (p.sh. kl
2–4). Kujdes: Kjo renditje mund të ndryshojë
sipas parakushtit të nxënësit,-es veç e veç.

10–15 min.

Nevoja për kohë të përafërt, p.sh. 20 min.
(e dhënë e përafërt, duhet të vendoset nga
mësimdhënësi sipas gjendjes së parakushteve
të klasës).

Parathënie për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

Mësimi në gjuhën amtare ose të prejardhjes (MGJP; në Zvicër GJKA, mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor dhe të identitetit si dhe për përkujdesjen për shumëgjuhësinë, si një rekurs vetjak dhe shoqëror me shumë vlerë. Lidhur me këtë fakt, hulumtimet, linjat drejtuese, si edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës R(82) 18 dhe R (98) 6, janë të qarta që prej shumë kohësh. Megjithatë ky mësim zhvillohet, në krahasim me mësimin e rregullt, ende në kushte të vështira. Kjo gjë ndodh për arsye të ndryshme:

- Mësimi në gjuhën e prejardhjes në shumë vende, përsa i përket aspektit financiar dhe institucional, qëndron në themele të dobëta. Pagesa e mësimdhënësve në Zvicër është pothuaj si kudo çështje e vendeve të prejardhjes madje edhe e prindërve.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është më së shumti i lidhur jo mirë me mësimin e rregullt. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e klasave të rregullta, shpesh zhvillohen shumë dobët.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes zhvillohet në më të shumtën vetëm dy orë në javë, gjë që e vështirëson punën në vazhdimësi.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është, në të shumtën, vullnetarisht, detyrimi për nxënësit nuk është shumë i fortë.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes, si rregull, zhvillohet si mësim në shumë klasa, në të cilin marrin pjesë njëkohësisht nxënës që nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë. Kjo kërkon nga mësimdhënësit aftësi të lartë didaktike si edhe aftësi për të diferencuar nxënësit në klasë.
- Heterogjeniteti i bashkësisë së nxënësve në mësimin e gjuhës së prejardhjes është veçanërisht shumë i lartë edhe në raport me kompetencat gjuhësore të nxënësve, ndërkohë kur disa sjellin nga shtëpia njohuri të mira në variantet dialektore ose të standardit të gjuhës së parë, të tjerë e flasin këtë vetëm në dialekt. Shumica që jeton tashmë në gjeneratën e dytë apo të tretë në vendin e ri të emigrimit, gjuha e atij vendi (p.sh. gjermanishtja) është bërë gjuhë e fortë, derisa gjuhën e parë e zotërojnë vetëm në variantin dialektor, dhe atë vetëm gojarisht dhe me një leksik të kufizuar rreth temave familjare.

- Mësuesit e gjuhës së prejardhjes parimisht kanë marrë në vendet e tyre të prejardhjes një arsimim të mirë bazë, por nuk janë të përgatitur për realitetin dhe specifikat e mësimin në shkollat me shumë klasa në emigrim. Mundësitë e kualifikimit në vendet e emigrimit zhvillohen në masë ende të pamjaftueshme.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» i përkrah mësimdhënësit e këtij mësimi në detyrën e tyre të rëndësishme e me kërkesa të larta, e me këtë dëshiron të japë ndihmesë për një cilësi maksimale të tij. Nga njëra anë është me rëndësi dhënia e principeve dhe e arsyeve të pedagogjisë dhe didaktikës në vendet emigruese perëndimore dhe evropianoveriore, (krahaso fletoren «Bazat dhe sfondet») nga ana tjetër dhënia e shtysave dhe modeleve mësimore praktike e konkrete. Përparësi përbën këtu përkrahja e kompetencave gjuhësore. Tek shtysat didaktike në mënyrë të vetëdijshme përdoren principet dhe metodat, të cilat për nxënësit janë të njohura nga mësimi i rregullt dhe tekstet mësimore përkatëse. Për këtë do të duhej që mësimi në gjuhën e prejardhjes dhe mësimi i rregullt, mundësisht t'i afrohen njëri-tjetrit në kuptim të një koherence të madhe. Përmes faktit që mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, njohin edhe elemente didaktike dhe metoda konkrete, që janë aktuale tek nxënësit në mësimin e rregullt, ata bëjnë njëkohësisht një pjesë kualifikimi dhe shpresojmë për një forcim të formimit të tyre si partnerë të barasvlershëm në procesin arsimor me nxënësit e rritur në sfondin dygjuhësor respektivisht dykulturor.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet nga Qendra «International Projects in Education (IPE)» dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih. Ajo lindi mes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet personave profesionistë zviceranë, atyre evropianoperëndimor në njërin anë, dhe të ekspertëve e mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, nga ana tjetër. Me këtë do të sigurohet se dhënia e informacioneve dhe e shtysave u përgjigjet gjendjes faktike, nevojave dhe mundësive të mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe se janë funksionale e praktike për këtë mësim.

1. Të shkruarit në gjuhën e prejardhjes: jo i thjeshtë, por i rëndësishëm

Të shkruajnë dhe të lexojnë në gjuhën e tyre të parë -ose amtare, për shumë fëmijë, prindërit ose gjyshërit e të cilëve kanë emigruar, është e vështirë ose gati e pamundshme. Nëse nuk do të shkollohen këto aftësi letrare, atëherë këta fëmijë do të mbeten analfabet/e në gjuhën e tyre të parë. Përmes asaj që gjuhën e prejardhjes e zotërojnë vetëm në të folur dhe shpesh në formë dialektore, ata e humbin lidhjen në kulturën e tyre të shkrimit. Me këtë rritet rreziku që ata ta humbin një kompetencë veçanërisht të rëndësishme dhe një pjesë integrale të identitetit dykulturore - në një kohë të shkurtër apo të gjatë. Përkrahja e kompetencave bilaterale (të mund të lexojnë e shkruajnë edhe në gjuhën e tyre të parë) është një çështje e rëndësishme edhe në kuptim të një zhvillimi tërësor të baraspeshuar të identitetit dykulturore resp.- dygjuhësor.

Një kontribut vendimtar tek zhvillimi i këtyre kompetencave e jep mësimi në gjuhën e prejardhjes (në Zvicër: Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut). Veçanërisht për fëmijët e familjeve më pak të arsimuara, ky mësim është pakashumë instanca e vetme ku gjuha e prejardhjes mësohet në versionin standard dhe të shkruar dhe me këtë edhe mundësia për të arritur të një kulturë tërësore e të shkruarit të dygjuhësisë gjithëpërfshirëse.

2. Objektivat dhe mbarështrimi i kësaj fletoreje

Botimi i pranishëm i përkrah mësimdhënësit dhe nxënësit/et e mësimi në gjuhën e tyre të prejardhjes në atë që të zhvillojnë kompetencat në të shkruar në gjuhën e parë në një mënyrë didaktike aktuale dhe motivuese e të gëzueshme. Pas një hyrjeje në pikat thelbësore të didaktikës së të shkruarit, pason një bollëk me nxitje dhe propozime mësimore konkrete.

Të vetëdijshëm se shumë nxënës/e do të kenë bllokada të mëdha së paku në nismë, fletorja fillon me një tufë të formave të thjeshta përmes lojës të cilat e zgjojnë motivimin në të gjitha nivelet e moshave. Sipas gjyqimit se njohuritë strategjike janë gjithashtu të rëndësishme si njohuritë faktike, në pjesën e dytë pasojnë teknikat dhe strategjitë, të cilat u ndihmojnë nxënësve/eve në faza të ndryshme të procesit të të shkruarit. Pjesa e tretë përfshin nxitje të shumta konkrete për përkrahjen e aspekteve të pjesshme si, fjala vjen, puna në leksik, në ndërtim të tekstit ose në stil.

Pjesa e fundit ofron një mori të nxitjeve dhe ideve, të cilat në aspektin tematik janë të përshtatshme për kontekste të mësimi në gjuhën e prejardhjes, bashkëpunimit me mësimin e rregullt ose me projekte kre-ative-muzikore.

Tek secili propozim gjenden, për orientim të shpejtë, udhëzimet për formën sociale (nga puna individuale deri te mësimi me tërë klasën), për nivelin e moshës, për të cilën është e përshtatshme nxitja përkatëse (p.sh. për klasat 3–7) dhe për kohën përafërsisht të nevojshme. Natyrisht që tek secila nxitje janë formuluar në mënyrë të kuptueshme dhe përkatëse edhe qëllimet dhe mënyra konkrete e rrjedhës. Të gjitha propozimet mësimore janë lexuar dhe provuar praktikisht nga mësimdhënësit të ndryshëm të mësimi në gjuhën e prejardhjes.

3. Pikat thelbësore të didaktikës aktuale në të shkruarit e tekstit

Parashtrimet vijuese lidhen me didaktikën e sotme të të shkruarit në vendet gjermanishtfolëse, por natyrisht i reflektojnë edhe zhvillimet ndërkombëtare. Karakteristike për konceptin e ri të 30 vjetëve të fundit është nocioni «Didaktika e të shkruarit të tekstit» i cili e ka zëvendësuar termin e mëhershëm «Mësim hartimi». Me këtë lidhet një nocion teksti shumë më i gjerë, larg nga hartimi shkollor klasik.

Në pikat thelbësore të didaktikës së shkrimit të tekstit (i cili ndoshta pjesërisht dallohet edhe nga ajo që e sjellin shumë mësimdhënësit të mësimi në gjuhën e prejardhjes nga arsimimi i tyre personal) numërohen pesë pikat vijuese. Ne po i paraqesim ato në raport me mësimin në gjuhët e prejardhjes dhe do t'i sqarojmë disa pika plotësuese në kapitullin 4, të cilat janë specifike dhe shumë të rëndësishme për këtë mësim.

a) Të mundësohet që të shkruarit të përjetohet si kategori sociale: të sqarohet për kë dhe për çka shkruhet!

Me përjashtim të rasteve të pakta (p.sh., ditari, fletë blerëse) të shkruarit është një proces komunikues njerëzor me të cilin njeriu i drejtohet një apo më shumë njerëzve, për t'iu thënë diçka ose për të arritur diçka. Këtë karakteristikë të procesit të të shkruarit do të duhej që nxënësit/et të mund ta përjetojnë vetëdijshëm si praktikë dhe veprimtari sociale që nga fillimi. Me fjalë të tjera: nëse nga nxënësit/et do të kërkohet të shkruajnë, ata duhet të dinë, për kë dhe për çka shkruajnë, gjegjësisht çfarë ndodh me tekstin pasi që të

shkruhet. Vetëm që të shkruhet thjesht për mësimdhënësin dhe lapsin e tij të kuq, kjo definitivisht nuk është e mjaftueshme si referencë adresimi.

Në vend të kësaj mësimdhënësi duhet të mendohet (eventualisht bashkë me nxënësit-et) në çdo rast të të shkruarit, çfarë duhet të ndodhë me tekstet (të lexohen ose të paraqiten para klasës, të lidhen në një libër, të përdoren në formë të korespondencës etj.). Idetë për referencën e adresimit gjenden në kapitullin 12, ato natyrisht lejojnë që të përdoren në situata dhe raste të ndryshme të të shkruarit.

b) Raporti me botën jetësore dhe të fantazisë së nxënësve/eve, detyra motivuese në të shkruarit

Temat e rasteve të të shkruarit duhet të qëndrojnë në raport të ngushtë me botën jetësore të nxënësve/eve por edhe me dëshirat e tyre, ëndërrat dhe fantazitë. Për ta arritur këtë raport duhet së pari dhënia e detyrave përkatëse, motivuese. Të tilla gjenden me bollëk në propozimet vijuese mësimore, duke filluar nga të thjeshtat, shembuj shkrimi të një niveli të ulët e deri te projektet e mëdha. Është e nevojshme, së dyti, një përgatitje përmbajtësore paraprake (të shumtën gojarisht) dhe një dakordim i nxënësve/eve. Këtu përfshihen udhëzime të qarta, të prera, si dhe pritjet dhe kriteret, në të cilat nxënësit/et mund të orientohen. Planifikimi përmbajtësor dhe i saktë i detyrave me shkrim, me vështrim referencën/at e adresimit, i takon pa kurrfarë dyshimi profesionalitetit të mësuesve/eve të sotëm/të sotme.

c) Nocioni i zgjeruar për shumëllojshmëritë e tekstit, mediat dhe funksionet e të shkruarit

Derisa më herët në shkollë para së gjithash janë shkruar hartime përjetimi, nxënësit/et e sotëm përgatiten për një varg shumë më të gjerë të shumëllojshmërisë së teksteve, ashtu si edhe i përgjigjet jetës reale: sipas situatës do të duhej të përmbledhesh raporte, formula-re, sms, letra, pllakate, poezi të thjeshta, kërkesa, tekste fantazie, tregime me ilustrime etj.

Në këtë rast do të duhej të përdorëshin edhe mediat e reja si kompjuteri, ose telefoni i dorës/smatphone me mundësitë e tyre (përpunimi i tekstit, e-mail, sms, blogs, chat). Kjo është e mundur edhe në mësimin e gjuhës së prejdardhjes dhe çon tek një varg i projekteve interesante në të shkruar, siç edhe tregojnë propozimet mësimore në pjesën praktike

d) Të shkruarit i përcjellur («i drejtuar») dhe i lirë («i nxitur»)

Në kuptim të një përkrahjeje efektive do të duhej që në rastet e të shkruarit shkollor të jepen situata të përcjellura (të drejtuara) dhe të lira (të nxitura).

Tek të shkruarit e përcjellur ose të drejtuar në plan të parë qëndron ndërtimi dhe zgjerimi i kompetencave të pjesshme gjuhësore (p.sh. leksiku, fillimet e fjalive, modele të ndryshme sintaksore, ndërtimi i tekstit). Për këtë fokus nxënësit-et marrin pak a shumë specifikit e detajuara dhe udhëzimet, të cilat ata do t'i zbatojnë. Një formë veçanërisht e lartë didaktike është e ashtuquajtura scaffolding (nga anglishtja scaffold = skele), tek e cila nxënësit/et mbështeten fort në një strukturë të paradhënë, këtë e ndryshojnë me përmbajtjen e tyre personale dhe kështu e zgjerojnë kompetencën e tekstit me një aspekt të ri (p.sh. variacioni i një letre përmes zgjedhjes së një adresimi të ri, «tregime paralele», tek të cilat mbi modelin e dhënë do të ndërrohet, fjala vjen, një figurë, një vend ose një send.

Në bazë të vlerës së kësaj procedure edhe për nxënësit/et e dobët në aspektin gjuhësor në mësimin e gjuhës së prejdardhjes do të merremi me këtë në mënyrë speciale në kapitullin 4 a; krahaso edhe nxitje të ndryshme praktike në pjesën III.

Si raste të lira apo nxitëse të të shkruarit do të shenjohen ato raste, në të cilat nxënësit/et do të nxi-ten për një temë apo projekt shkrimi (p.sh. përmes një dakordimi gojor për një temë fantazie ose përmes një bisede paraprake për një tekst tematik, por pa u orientuar ngushtë me një model të paradhënë. Pritjet e komunikuar qartë dhe eventualisht kriteret në raport me tekstin e pritur, i përkasin gjithashtu këtij lloji. - Rastet e të shkruarit krejt të lirë pa dakordim dhe përgatitje («ju keni tash një gjysmë ore të shkuani diçka») i mbingarkojnë shumë nxënës/e. Me rëndësi në këtë kontekst me të shkruarit e lirë është që nxënësit/et të inkurajohen që të shkruajnë në gjuhën e tyre edhe jashtë shkollës (letra, ditar, e-mail-e etj.).

e) Orientimi i procesit dhe përkrahja e qartë e strategjive të të shkruarit

Shumë nxënës/e ndjehen të mbingarkuar me detyrat në të shkruar, nëse ata mendojnë vetëm në produktin e kërkuar final. Është ndihmuese që në vend të kësaj të fokusohen tek procesi. Nxënësit/et duhet të mësojnë strategjitë, se si një proces të të shkruarit ta nëndajnë në hapa të dukshëm dhe të mund ta përfundojnë këtë në një renditje të kuptueshme. Hapa të tillë të rëndësishëm janë: të gjenden idetë/të aktivizohen paranjohuritë - ndërtimi i tekstit të planifikohet dhe të strukturohet - teksti të përmbledhët - teksti të përpunohet - teksti të prezentohet. Në mënyrë që nxënësit/et strategjitë e të shkruarit t'i përvetësojnë vërtet në mënyrë të qëndrueshme, duhet që dhënia e tyre të bëhet në mënyrë të qartë. Teknikat dhe strategjitë mësimore në pjesën e dytë shërbejnë mu për këtë qëllim. Dy fletë pune i përmbledhin gjërat më të rëndësishme dhe mund t'u jepen nxënësve/eve nga klasa e katërt si mjet për përkrahje.

4. Pika plotësuese në lidhje speciale me shkrimin e teksteve në kuadër të mësimit në gjuhën e prejardhjes.

Si karakteristikë e mësimit në gjuhën e prejardhjes numërohet edhe heterogjeniteti i nxënësve/eve dhe fakti që shumë nxënës kanë probleme me aspekte letrare, posaçërisht të kërkesave të larta, në gjuhën e tyre të parë. Andaj për të shkruarit në mësimin e gjuhës së prejardhjes rezultojnë edhe disa pika plotësuese që janë me rëndësi të veçantë.

a) Hyrje në sistemin e të shkruarit në gjuhën e parë

Nxënësit-et të cilët janë alfabetizuar në gjuhën e vendit të ri - e jo në gjuhën e prejardhjes, duhet të udhëhiqen me kujdes në sistemin e shenjave - dhe të tingujve (fonemat, grafemat) në gjuhën e parë. Tek gjuhët të cilat shkruhen me alfabetin latin, kjo i përket para së gjithash atyre shkronjave të cilat nuk janë të njohura në gjuhën e shkollës (p.sh. shkronjat ë, ç,). Për t'i mënjeluar konfuzionet, shumë mësime ndihen ua mësojnë nxënësve këto shkronja tek në përfundim të alfabetizimit në gjuhën shkollore (në fund të klasës së parë në fillim të klasës së dytë). Tek alfabetet jolatine ka më pak rrezik të ndërrimit me gjuhën e shkollës, por për këtë duhet të ndërtohet tërë alfabetizimi në gjuhën e parë.

b) Ndërtimi dhe zgjerimi i leksikut diferencues në gjuhën e parë

Shumë nxënës/e në emigrim kanë zbrazësi të theksuara në leksikun e gjuhës së parë. Ata e zotërojnë këtë në lidhje me temat familjare dhe në dialekt. Për krejt të tjerat - posaçërisht për tema me kërkesa të larta dhe të lidhura me shkollën - ata e përdorin gjuhën e shkollës ose të rrethit të vendit në të cilin ata rriten. Leksiku i këtyre fëmijëve ndahet në dy pjesë, duke ecur kështu në drejtim të kundërt me zhvillimin gjithëpërfshirës të kompetencave dygjuhësore. Një qëllim i rëndësishëm i mësimit në gjuhën e prejardhjes duhet të jetë ndërtimi i leksikut zhvillues e diferencues, i cili i përfshin format e gjuhës standarde. Për t'i dalluar janë posaçësisht fjalët, të cilat nxënësit/et duhet t'i zotërojnë aktivisht (leksiku aktiv ose produktiv, ky duhet të ushtrohet vazhdimisht dhe duhet të përfshijë para së gjithash fjalët që përdoren më së shpeshti) dhe fjalët të cilat nxënësit/et i kuptojnë, por nuk duhet patjetër t'i përdorin vetë (leksiku receptiv (pasiv) ose të kuptuarit). Rëndësisë së madhe në punën me leksik i përgjigjen në doracakun e pranishëm nxitje të shumëllojshme në kapitujt 14 dhe 15.

c) Udhëheqja për tek gjuha standarde

Përpos leksikut të kufizuar, një karakteristikë tjetër e nxënësve/eve në emigrim është se e zotërojnë gjuhën e tyre të parë (gati) vetëm në variantin dialektor, por jo në atë me shkrim apo variantin e standardit. Për këtë arsye, tek detyrat e mësimit në gjuhën e prejardhjes, duhet të llogaritet një udhëheqje e kujdesshme për tek varianti i standardit, zotërimi i të cilit është parakusht për hyrjen në të shkruar dhe për të shkruarit korrekt personal. Principe të rëndësishme për këtë udhëheqje (e cila mund të fillojë nga viti i parë shkollor) janë:

- 1) Kujdesi: gëzimi në të shkruar i fëmijëve është me përparësi dhe nuk guxon të shkatërrohet përmes një orientimi të tepruar në normë.
- 2) Një fillim krahasues, zbulues: Në vend të dhënies së normës do të duhej që dallimet mes gjuhës standarde dhe dialektit gjithkund ku është e mundur të bëhen vetëdijshëm përmes të mësuarit krahasues dhe zbulues.
- 3) Shumë raste të përshtatshme ushtrimi: ajo çka është dhënë në lidhje me gjuhën standarde (leksiku, gramatika), duhet të përsëritet mjaftueshëm me raste të përshtatshme në të shkruar dhe të ushtrohet në mënyrë që vërtet të mund të përvetësohet.

d) Scaffolding: strukturat mbajtëse/«skelat» të jenë gati për nxënës/e gjuhësisht të dobët

Përdorimi shkollor i gjuhës i shfrytëzon në shumë drejtime mjetet gjuhësore komplekse (leksiku, gjuha standarde etj.) se sa përditshmëria. Udhëheqja për tek kjo «gjuhë arsimimi» me të cilën lidhet edhe kompetenca e tekstit (kompetenca për t'u konfrontuar me tekstet e shkruara në mënyrë produktive ose receptive), është një detyrë e kërkesave të larta. Një metodë shumë aktuale dhe e suksesshme këtu, në mësimin e gjermanishtes dhe të gjermanishtes si gjuhë e dytë, është ajo që theksuam më lart, pra scaffolding. Ky veprim është i përshtatshëm në mënyrë të shkëlqyeshme edhe për mësimin në gjuhën e prejardhjes. Nxënësit/et marrin për aspekte të caktuara (p.sh. leksik, struktura fjalish, ndërtim teksti) si ndihmë së pari një skelë (gjegjësisht një model ose një strukturë) përmes së cilës ata mund të orientohen. Kjo mund të jetë p.sh. një skemë ndërtimi si tek «poezitë-njëmbëdhjetëshe» (krahason nr. 21.1) e cila merret dhe plotësohet me fjalë personale. Ose jepen paraprakisht tregulla ndërtimi-të tekstit, gjegjësisht elemente për një pjesë të caktuar të një teksti (p.sh. fillime fjalish ose folje të përshtatshme për një tregim të ilustruar), përmes së cilave nxënësit/et e shkruajnë ose e përmbledhin tekstin e tyre personal, ose jepen paraprakisht hapa të saktë me të cilët do të duhej të ndërtohet një tekst i thjeshtë (p.sh. një recetë ose një udhëzim). Në të gjitha rastet nxënësit/et do të lehtësohen përmes «skelës» si pjesë e detyra-

ve me shkrim (p.sh. nga ndërtimi i tekstit) përmes asaj që ata i shfrytëzojnë pjesët e paradhëna. Pasi që ata automatikisht mund t'i marrin dhe përdorin modelet përkatëse, fjalët ose shprehjet, atëherë ata e zgjerojnë repertoarin e tyre gjuhësor në mënyrë aktive vetanake. Shumë propozime mësimore, para së gjithash në pjesën e tretë (nxitje për përkrahjen e pjesës së aspekteve të të shkruarit), paraqesin variante të thjeshta të scaffolding (krahaso 14.1: fushat e fjalëve, 15.2 provë zëvendësuese, 16.3: tekste paralele). Për informacione të mëtejshme për scaffolding krahaso ndër të tjera

<https://www.uni-due.de/imperia/md/content/prodaz/scaffolding.pdf>.

e) Vërejtjet rreth drejtshkrimit

Rregullat e drejtshkrimit dhe problemet lidhur me to janë të paktën pjesërisht specifika gjuhësore, prandaj ne nuk do ta shqyrtojmë këtë aspekt në kuadër të doracakut të pranishëm. Në përgjithësi, si principe për ushtrime efektive në drejtshkrim mund të theksohen në fund të fundit këto:

- 1) *Orientimi në leksikon bazë*: ndërtimi i leksikut të drejtshkrimit si dhe korigjimi i gabimeve do të duhej të orientohen në *shpeshtësinë e përdorimit* të fjalëve. Sa më e shpeshtë një fjalë aq më e rëndësishme është që të njihet mënyra e drejtë e të shkruarit.
- 2) *Korrektura e pjesshme*: Nëse nënvizohen të gjitha gabimet, kjo çon parimisht në dekurajim. Më e kuptimtë është që të nxjerren pesë tipet e gabuara më të rëndësishme dhe pastaj të planifikohet për to një ushtrim eficient disapjesësh.
- 3) *Përmirësimet e dobishme, ushtrimi disapjesësh, i qëndrueshëm*: Të shkruarit korrekt tri herë i një tipi të gabuar, shikuar në aspektin psikologjiko-mësimor nuk sjell asgjë. Më të dobishme dhe efektive janë ushtrimet dhe format e përmirësimit, tek të cilat fjalët e zgjedhura do të ushtrohen në sekuenca të shpërndara në një kohë 2–3 javësh.
- 4) *Ndihmë për vetëndihmë*: Udhëheqja bazë në përdorimin e fjalorëve të drejtshkrimit është parakusht thelbësor në mënyrë që nxënësit/et të mund t'i përdorin këto mjete ndihmëse.

5. Për dhënien e notave dhe vlerësimit e punës në të shkruar: pika të rëndësishme

• Instancat e dhënies së notave:

Dhënia e notave tek produktet në të shkruar nuk do të duhej të jetë çështje vetëm e mësimdhënësit. Tek një koncept komunikues, i lidhur me adresim (shih lart, 3.a) shpërfaqjet e lexuesve/eve janë gjithashtu me shumë vlerë dhe të rëndësishme. Ato do të duhej të përdoreshin qysh gjatë procesit të të shkruarit. Këtu janë të përshtatshme format siç është, fjala vjen, konferenca e të shkruarit (krahaso kapitullin 11.1) të cilën shumë nxënës e njohin nga mësimi i rregullt. Mësimdhënësit i takon posaçërisht roli i një instance përfundimtare të korigjimit, i cili mund dhe duhet të japë impulse orientuese përkrahëse për zhvillim të mëtejshëm.

• Orientimi sipas kriterëve:

Një problem kryesor i vlerësimit të hartimit ka qenë subjektiviteti i madh dhe jotransparenca. Për t'i ikur këtij rreziku, do të duhej që së paku para rasteve të mëdha të të shkruarit të formulohen pritje të qarta për tekstet. Kjo do të duhej të ndodhte në formë të 4–5 kriterëve, të cilat më së miri do të përpunoheshin bashkë me nxënësit/et. (për shembull: teksti do të duhej të ketë së paku 1 faqe, të tregojë një ndarje të qartë të hyrjes/pjesës kryesore/përfundimit, të përmbajë së paku 4 informacione të rëndësishme ...). Lidhja me kriteret, edhe tek bisedimi dhe vlerësimi me nota i teksteve, kërkon transparencë dhe motivim.

• Të vlerësohet edhe procesi:

Tradicionalisht vlerësohet para së gjithash një tekst i përfunduar. Mu tek nxënësit/et me kompetenca të kufizuara në të shkruar nuk e marrim vesh në këtë mënyrë se me çfarë vështirësish janë ndeshur. Për këtë do të duhej t'i kthehemi procesit të kaluar të të shkruarit. Nëse për shembull dikush e ushtron një strategji të caktuar të të shkruarit, mund të vëzhgohet se a shkruan dikush veç ashtu, ose vërtet përpiket që ta zbatojë strategjinë e kërkuar.

- **Mënyra e shpërfaqjes:**

Dhënia prapa e një teksti të korrigjuar dhe të shënuar me një notë nuk është më i mjaftueshëm për standardet e sotme. Orientimi përkrahës do të thotë që nxënësit/et të marrin një koment ndërtues, me gojë ose me shkrim (feedback), për tekstet e tyre dhe udhëzime konkrete për punë të mëtejshme

- **Orientimi nga kompetencat:**

Orientimi në kompetencat e definuara (shpesh të diferencuara në kompetenca minimale-, normale- dhe të zgjeruara) në diskutimet arsimore është temë aktuale. Për mësimin në gjuhën e prejdardhjes do të duhej të trajtohet në një kontekst më të madh. Për aspektin e gjuhës do të ishte që, ndër të tjera, të merrej lidhja me kornizën e përbashkët referuese evropiane, krahaso <http://www.goethe.de/z/50/commeuro/303.htm>.

Për udhëzime të vlefshme për pjesën hyrëse i falënderoj
Claudia Neugebauer, Claudio Nodari, Stefan Mächler dhe
Peter Sieber.

**Për fillim: shembuj të të shkruarit
të nivelit të ulët dhe aktivitete për
përkrahjen e motivimit**

Ushtrim paraprak: Të rrëfihen bashkërisht tregime sipas radhës, vazhduese ose tregime zinxhir

Qëllimi

Në formë loje dhe të nivelit të ulët të përkahet gëzimi në të treguar, kjo edhe si ushtrim paraprak për format në të shkruar (shih poshtë nr. 2). Ushtrimi përkrah njëkohësisht të treguarit, gjegjësisht kompetencën e të shprehurit në gjuhën e parë.

Të rrëfihen bashkërisht tregime në radhë, vazhduese ose tregime zinxhir

kl. 1-6

10-15 min.



Rrjedha:

a) N ulen mundësisht në rreth. M ose një N tregon me një ose disa fjali fillimin e një tregimi (Shembull: Ishte ora tre e natës; gjithçka shtrihej në errësirë të thellë. Dera e shtëpisë u hap pa zhurmë në bllokun e zymtë të banimit.) Nxitja: Këtë tregim dëshirojmë ta sajojmë bashkërisht!

b) N e thurin më tutje tregimin me nga një ose disa (më së shumti pesë) fjali për N. Kjo mund të ndodhë tërthorazi nëpër klasë ose në radhë. Me rëndësi është që të gjithë të vijnë në shprehje.

Vërejtje:

- Fillime interesante mund dhe duhet t'i mbledhin e sjellin edhe N. Burime të mundshme: fantazi personale, fjali nga librat ose lajmet nga gazetatat, ilustrim/fotografi me një situatë interesante fillestare.
- Mund të jetë me vlerë një paracaktim i qartë komunikues në formën: ne kemi 10 minuta kohë, në fund tregimi duhet të jetë deridiku i harmonizuar, respektivisht të vijmë tek një përfundim.
- Në mënyrë që të gjithë N të vijnë në shprehje në mënyrë të balancuar, M mund t'i shpërndajë paraprakisht çdo N dy ose tri pulla ose një copëz flete. Kush e ka thënë një fjali e jep një pullë ose një copëz flete prapa. Deri në fund do të duhej të jepeshin prapa të gjitha pullat ose copëzat e fletave.
- Paracaktime të tjera të mundshme: duke u ndërruar do të mund të vazhdonin më tutje një vazjë/një djalë ose një fëmijë i ri/një i vjetër.
- Që të mos dëmtohet spontaniteti, do të duhej mundësisht të mos korrigjohet. Intervenimet duhet të kufizohen vetëm nëse diçka është e pakuptueshme ose e pahijshme.
- Vazhdimi i mundshëm: N shkruajnë (vetëm ose me partner) tregimin e sajuar bashkë; në përfundim tekstet do të krahasohen.
- Ushtrimi është i përshtatshëm edhe në përfundim të një ore ose edhe për shtendosje të ndërmjetme.

Variantet:

1. Në vend se me tërë klasën, ushtrimi mund të zhvillohet edhe me vetëm një ose dy grupe nivelesh, nëse është bërë një hyrje e mirë.
2. Varianti «Peri i kuq»: dikush fillon me tregimin dhe e mban në duar një lëmsh mëndafshi ose një lëmsh peri. Në vazhdim ai e mban lëmshin në dorë dhe ia jep perin personit, i cili vazhdon më tutje (ose e zgjedh vetë dikend për të treguar më tutje). Tjetri vazhdon më tutje, e mban perin në dorë dhe e jep lëmshin më tutje. Kështu, paralelisht me zhvillimin e tregimit, ndërtohet një rrjet i tërë i penjve mes për mes klasës. Njëkohësisht shihet se kush nuk ka qenë ende në radhë për të treguar. (Burimi: Zopfi (1995), 67.)

Qëllimi

Në formë loje dhe të nivelit të ulët të përkrahët gëzimi dhe të zgjohet kreativiteti në të shkruar dhe në të treguar në gjuhën e parë.

Të shkruarit bashkërisht: tregime radhe, vazhdimi, zinxhir ose palosëse

kl. 1–9

15–20 min.



Materiali:

Nga një fletë për N; e zbrazët ose me fjalë të përgatitura ose një pjesë (nga fantazia e M ose nga një tekst apo nga një grumbullim i fjalëve fillestare, të cilat janë përpunuar me klasën). Nëse fleta jepet e zbrazët, atëherë duhet që N ta sajonnë vetë fillimin.

Rrjedha:

Modeli bazë është ky:

- Secili/a N e merr një fjali ose një pjesë të vogël si fillim të një tregimi ose e shkruan vetë një fillim të tillë lart në një fletë.
- Pastaj ai/ajo ia jep fletën tutje N djathtas. Ky/kjo e lexon se çfarë është e shkruar aty dhe e shkruan tregimin më tutje (një ose dy fjali). Pastaj ai/ajo e jep më tutje gjithashtu fletën djathtas.
- Kur të gjitha fletët njëherë kanë qarkulluar nëpër tërë klasën ose grupin, atëherë ushtrimi është i përfunduar.
- Në përfundim tregimet do të lexohen ose do të varen në mur.

Vërejtje:

- Është me rëndësi që aty nga fundi i sekuencës (kur gati të gjitha fletët kanë qarkulluar nëpër klasë) të theksohet që dy tri fjalitë e fundit do të duhej të drejtohen nga përfundimi, në mënyrë që tregimi të mos përfundojë thjesht papritur.
- Para se gjithash për fëmijët e rinj është me rëndësi së pari të sajohen tregime gojore radhe; krahaso këtu me nr. 1 lart: ushtrim paraprak.

Me korrigjimet M do të duhej që të merret me kujdes, në mënyrë që të mos zvogëlohet motivimi në të shkruar. Por M duhet t'i shikojë mirë tekstet, sepse ato ndoshta japin udhëzime për fusha përkrahëse aktuale në të cilat shumë N bëjnë gabime.

Variantet:

- Në vend se me tërë klasën, ushtrimi mund të zhvillohet edhe me vetëm një ose dy grupe nivelesh, nëse është bërë një hyrje e mirë.
- Është e mundshme që të formohen grupe nga 3–4 fëmijë, të cilët do të shkruanin nga një tregim zinxhir. Fletët në këtë rast do të qarkullojnë më shumë se njëherë nëpër grup.
- Është e mundshme gjithashtu që të qarkullojë vetëm një fletë. Në mënyrë paralele me mësimin tjetër ndërtohet në të një tregim, i cili lexohet në fund para të tjerëve.
- Tregimi palosës: Në vend që të mund të lexohet se çfarë veç është shkruar, fleta para se të jepet tutje duhet të paloset ashtu që të mund të shihet vetëm fjalia e fundit, e jo edhe fjalitë e tjera të shkruara më lart. Kështu ndërtohet një tekst për lexim përfundimtar, i cili sjell më shumë kureshtje dhe befasi.
- Fjalë për fjalë: Ky është një variant për grupe të vogla me N të rinj. Në vend të fjalëve (1–2 fjali) mund të shkohet edhe me fjalë: Në fillim qëndrojnë shirita të gjatë të letrës (A 3 mes për mes në 4–5 linja të priten), në të cilët qëndron nga një fjalë si fillim fjalie (ose do të shkruhet). Çdo N shkruan gjithnjë vetëm nga një fjalë (ose më së shumti tri fjalë) të tjera dhe e jep pjesën e letrës më tutje. Kështu krijohen shirita letre me fjali.



3

Tregime dypikëshe, tregime me fjalë «kapëse», tregime me fjalë dëshirash dhe tregime kush-ku-çka

Qëllimi

Katër propozimet vijuese përkrahin, përmes karakterit të tyre atraktiv dhe të nivelit të thjeshtë, kreativitetin dhe gëzimin në të shkruar në gjuhën e parë. Ato janë të përshtatshme për përpunim në grupmosha të ndryshme, ku të rinjtë mësojnë diçka nga të vjetrit.

1. Tregimet dypikëshe

kl. 3–6

20 min.



Materiali:
Fletë me fillime fjalish
(për N një fletë)

Udhëzim për literaturë:
Baumann-Schenker/Ernst,
2007, f. 66.

a) Si hyrje shërbejnë një ose dy fjali. Ato duhet të përfundojnë me dy pika. Secili N e merr ose e përmbledh një fillim të tillë.

b) Ai/ajo e vazhdon më tutje tregimin me dy fjali dhe e jep fletën tutje. Me rëndësi: Secili vazhdim duhet të përfundojë gjithashtu me një fjali me dy pika.

Për shembull:

Na ishte një herë një mi i vogël.
Ai u mendua:

«Sikur të isha shumë i madh dhe i fortë!» - Në atë moment erdhi një mace atypari dhe e pa miun. Ajo qeshi në mënyrë të poshtër dhe tha:

«.....»

c) Pasi që fletët kanë qarkulluar nëpër tërë klasën, ato do të lexohen. Në këtë rast N vlerësojnë se a është plotësuar detyra në mënyrë korrekte.

2. Tregime me fjalë «kapëse»

kl. 3–6

20 min.



a) Secili/a N e shkruan një fjali lart në një fletë dhe e jep atë më tutje.

b) N tjetër shkruan një fjali tjetër, në të cilën fjali së paku një fjalë merret nga fjalia e mëparshme (është «kapur»). Kjo fjalë do të nënvizohet. Pastaj ai/ajo e jep fletën më tutje dhe N tjetër e shkruan një fjali, në të cilën ndonjë fjalë nga fjalia e N 2 vjen në shprehje.

c) Rreth e rrotull klasës apo grupit derisa secili/secila e ka pasur secilën fletë. Variante: Tregimet-fjalë nxjerrëse mund të shkruhen edhe vetëm. Është thjeshtë me rëndësi që N në secilën fjali e nxjerr një fjalë nga fjalia e mëparshme.

3. Tregime - me fjalë dëshire

kl. 3–6

20 min.



Udhëzime për literaturë:
Zopfi, 1995, f. 47
(«Zettels Traum»).

a) Klasa është mbledhur në rreth. M i informon N mbi synimin për të shkruar bashkërisht një tregim, në të cilin vijnë në shprehje fjalë dëshirash të të gjithë N. Secili N do të duhej që të mendojë një fjalë që do të vijë në tregim dhe ta shënojë në një copëz letër.

b) Copëzat e letrave shtrohen në mes, në mënyrë që të gjithë të mund t'i shohin ato.

c) Kush e kërkon një fjalë dhe e fillon tregimin? Kush vazhdon me një fjalë, gjegjësisht me një copëz letre më tutje? – Paralelisht me të treguarit do të renditen copëzat e letrës ose do të ngjiten.

d) Në përfundim N e shkruajnë tregimin ashtu si u përmbledh më herët në rreth, ose në bazë të përfytyrimeve të tyre personale. Me rëndësi është që të gjitha copëzat e letrës të merren parasysh.

4. Tregimet kush-ku-çka

kl. 3–6

20 min.



Materiali:
Copëza letre të kuqe, të kaltra
dhe të verdha A6 ose A7.

a) N formojnë ekipe dyshe (me qejf edhe me grupmosha të ndryshme). Secili ekip i merr tri copëza letre në tri ngjyra të ndryshme. Në copëzën e kuqe të letrës e shkruan emrin e një personi ose të një kafshe, në copëzën e kaltër të letrës vendin, ku tregimi do të shtjellohet dhe në copëzën e verdhë të letrës, çfarë do të duhej të ndodhë (me 2–3 fjalë kyçe).

b) Copëzat e letrës do të mblidhen dhe do të përzihen.

c) Secili ekip i merr tri copëza letrash me ngjyra të ndryshme dhe me to duhet të sajorë një tregim.

d) Prezantimi përfundimtar.

4

Tregime skelë, tregime fjalënxitëse, tregime strukturë

Qëllimi

Në formë loje dhe të nivelit të thjeshtë, të përkrahët gëzimi në të shkruar dhe në të treguar në gjuhën e parë dhe të zgjohet kreativiteti. Të krijohen situata të thjeshta për krahasime teksti dhe vlerësimi

Tregime skelë, tregime fjalënxitëse, tregime strukturë

kl. 3–6

20 min.



Materiali:
Eventualisht fjalori, libër tjetër ose
gazetë për «nxjerrjen» e fjalëve.

Rrjedha (struktura bazë):

a) Në hapin e parë do të gjenden pesë fjalë (shih për këtë më poshtë) dhe shënohen në tabelë ose në një fletë.

b) Këto pesë fjalë formojnë strukturën ose skelën dhe rreth e rrotull secili N e shkruan një tregim. Të pesë fjalët duhet të vijin në shprehje në secilin tekst. (event. të nënvizohen me ngjyrë).

c) Në përfundim tekstet do të lexohen, bisedohet për to dhe/ose ngjiten. Interesante është këtu të shihet se si për «skelën» e njejtë rreth e rrotull janë ndërtuar «trupa tregimesh» krejt të ndryshme. Mund edhe të bisedohet dhe të vlerësohet gjithashtu se sa ka mundur që secili N të zotërojë detyrën që në tekstin e tij/e saj të ndërtojë të pesë fjalët skelë.

Vërejtje:

Procedura për t'i gjetur të pesë fjalët:

- M lëviz nëpër klasë me një fjalor në dorë, me një libër tjetër ose me një revistë. Pesë N guxojnë ta shfletojnë librin «verbaz» dhe me një laps të zgjedhin një fjalë. Kjo është atëherë një nga fjalët skelë.
- Të gjithë N shënojnë në një copë letër disa fjalë. Këto fjalë do të mbidhen dhe do të përzihen; dikush ose N të ndryshëm tërheqin gjithsej pesë copa letrash, këto formojnë strukturën ose skelën.

Variantet:

1. Në vend se me tërë klasën, ushtrimi mund të zhvillohet edhe vetëm me një ose dy grupe nivelesh, nëse është bërë një hyrje e mirë
2. Në vend të pesë mund të zgjidhen edhe tri ose katër fjalë. Më shumë se pesë fjalë të zgjidhen nuk rekomandohet.
3. Në vend të fjalëve mund të zgjidhen edhe shprehje ose fjali të vogla, të cilat do të formojnë skelën ose strukturën.
4. Një variant të bukur e propozon Zopfi (1995, f.49): Secili N guxon të dëshirojë një tregim, në të cilin vijin në shprehje tri ose pesë gjëra ose fjalë. Ai/ajo i shkruan këto pesë fjalë në një copë letër dhe ia jep dikujt tjetër më

tutje. Fëmija tjetër e shkruan me këtë një tregim dhe ia dhuron atë të parit. (Varianti: «Listat e dëshirave» vendosen në një shportë; secili fëmijë e tërheq verbazi një listë të tillë të fjalëve dhe shkruan në të). Zgjerim: Të luten prindërit ose dikush nga familja për një listë të tillë fjalësh dhe këtij personi t'i dhurohet me këtë një tregim. (Krahaso me këtë edhe 3, «Tregimet-fjalë dëshirash»).

5

Të shkruarit sipas fantazisë në forma të ndryshme sociale

Qëllimi

Në formë loje dhe në nivel të thjeshtë, të përkrahet gëzimi në të shkruar dhe në të treguar në gjuhën e parë si dhe të zgjohet kreativiteti. Të krijohen situata të thjeshta për krahasime tekste dhe vlerësimi

1. Tregime me partner

kl. 2–6

30 min.



Udhëzime për literaturë:
Büchel/Isler 2006, f. 146.

- Nga dy N punojnë bashkë (ata mund të jenë edhe nga grupmosha të ndryshme). N 1 e mendon fillimin e një tregimi (një fjali) dhe ia dikton këtë fjali fëmijës tjetër (N 2).
- N 2 e shkruan fjalinë e diktuar dhe mendohet se si mund të zhvillohet tregimi më tutje. Pastaj ai/ajo ia dikton fjalinë fëmijës së parë (N 1).
- Në përfundim ia lexojnë ekipet dyshe njëri-tjetrit tregimet e tyre. Variantet (në ± ekipet e suksesshme homogjene): Ushtrimi luhet pa fjalë: N 1 i shkruan një ose dy fjali (= fillimi i tregimit), N 2 vazhdon me një ose dy fjali më tutje etj.

2. Një titull - shumë tekste

kl. 3–6

30–40 min.



- M e jep një titull atraktiv që nxit fantazinë. Shembuj: «Sikur të mund të bëja magji» / «Unë pas dhjetë viteve» / «Nëse do të isha mbret/ëreshë (ose shef/e i/e pushtetit)» / «Dëshirat për vendin nga i cili vjen familja ime»
- Secili/a N shkruan një tekst për këtë ose e modelon një fletë A 3 me tekst dhe ilustrime.
- Ekspozitë, prezentim dhe diskutim për tekstet në grup ose në klasë.

3. Bashkërisht të shkruhet një libër aventurë

kl. 4–9

60–120 min.



Materiali:
Në dosje

- Detyra për N (në grupe ose si projekt i klasës): mendoni bashkërisht për dy personazhe kryesore, të cilët përjetojnë lloj-lloj aventurash - në vendin tuaj të prejdardhjes ose aty ku ju tash jetoni, ose kudo dikund në botë apo në gjithësi: si ju doni! Përcaktoni se si do të quhen të dy personazhet (më së miri një vajzë dhe një djalë), sa vjeç janë dhe a bëjnë diçka të veçantë (p.sh. magji, lëvizin tepër shpejt nëpër hapësirë dhe kohë ...). Bëni për të dy figurat bashkërisht një afishim (emri, mosha, hobi, veti të veçanta etj.), i cili do të jetë i vendosur në fillim të librit tuaj aventurë.
- Pastaj shkruan secili/a N një ose më shumë eventura të cilat i përjetojnë dy personazhet kryesore.
- Lexoni para njëri-tjetrit aventurat tuaja dhe mblidhni në një dosje.
- Shkruani përsëri aventura të reja dhe mblidhni ato. Me kohë do të ndërtohet një libër i vërtetë aventurë!

4. Bashkërisht të synohen përmbledhje të tjera të teksteve

kl. 3–9 30–120 min.



Materiali:
Një dosje.

Në mënyrë analoge me librin aventurë (shih lart) është e mundur të synohen përmbledhje të tjera. Parimisht kjo ndodh ashtu që fillimisht merren vesh për një temë dhe për këtë vendoset një dosje përkatëse, pastaj secili/a N i shkruan një apo më shumë kontribute për përmbledhjen e planifikuar dhe kjo përmbledhje udhëheqet për një kohë të caktuar, paralelisht me mësimin (me kontribute vullnetare ose dhënie të detyrave të shtëpisë).

Tema të mundshme për përmbledhje të tilla:

- Shaka, episode argëtuese
- Tregime/Aventura nga vendi i prejardhjes
- Tregime për kafshët
- Receta për gatime
- Udhëzime për punë dore

6

Detyra të vogla modeluese dhe kreative me gjuhë (krahase gjithashtu edhe nr. 23)

Qëllimi

Të përkrahet gëzimi në të shkruar përmes detyrave kreative të nivelit të thjeshtë, të cilat mund të zgjidhen edhe në ekipe të grupmohave të përziera.

1. Figura fjalësh për emrin personal

kl. 2–9 15 min.



L ozonjare
I nteligjente
N atyrshme
D uruese
A ktive

a) Në një fletë (A3 ose A4 e vendosur lart, mundësisht një fletë e fortë) e shkruan secili N mbiemrin e tij/e saj (ose emrin dhe mbiemrin) shkronjë për shkronjë njëzë në tjetrën. Shkronjat modelohen bukur dhe me ngjyra.

b) Për secilën shkronjë shkruhet një fjalë, e cila fillon me atë shkronjë. Nëse është e mundur do të duhej që fjala të përshtatet me fëmijën përkatës dhe p.sh. të shprehë një veti të tij/të saj ose të theksojë diçka çka fëmija e ka qejf.

2. Fjalë - shkallësh

kl. 2–9 20 min.



Q i r I
E k r a N
N i s j E
I r i Q

a) Secili/a N ose secili ekip dysh e merr një fletë (A4) dhe mendon për një fjalë me 4–7 shkronja. Kjo fjalë shkruhet në anën e majtë nga lart poshtë. Djathtas shkruhet e njëjta fjalë nga poshtë lart.

b) Fushat e mesme duhet të mbushen me fjalë të cilat fillojnë dhe mbarojnë me shkronjat përkatëse

3. Tregime-ABC

kl. 2–9 30 min.



Varianti 1:

Në një fletë të madhe (A3 ose A2) do të shkruhen shkronjat e alfabetit me ngjyra dhe të mëdha në njëra-tjetrën (event. në dy kolona; gjithsesi ashtu që pranë shkronjave të mbetet vend i mjaftueshëm). Për secilën shkronjë do të shkruhet një fjalë ose një fjali e shkurtër, në fillim të së cilës do të qëndrojë shkronja përkatëse e alfabetit.

Varianti 2:

N marrin për grup 2–3 shirita të gjatë letre (A3 të priten në mënyrë diagonale në katër shirita), që të ngjiten me njëra-tjetrën. Ata mendohen për fjali (-nonsense) ose një tregim, tek i cili çdo fjalë e rendit fillon me një shkronjë të alfabetit (p.sh.: Alma bleu ca dardha e ftonj goxha (të) hidhur).

4. Portret personal, afishim

kl. 2–9

45 min.



a) M bashkë me N mbledhin në një vend krejt çka i përket një afishimi: mbiemri, emri, mosha, hobi, gjella e preferuar, muzika -, lënda -, libri-, mësuesi i klasës prejardhja, adresa etj.

b) Në përfundim secili N e modelon në një fletë (A3, event. A4 mundësisht letër e fortë) portretin personal, gjegjësisht një afishim për veten. Kjo mund të zbukurohet edhe me ndonjë vizatim, fotografi, me figura dhe objekte të tjera.

c) Prezentimi përfundimtar dhe diskutimi i përbashkët se çka dhe në cilin afishim është bërë diçka më së miri.


5. Punë e përbashkët: pema e tregimeve ose e dëshirave

kl. 2–9

70 min.



Materiali:
Tabak i madh letre A1.
Fletë të gjelbërta A4



a) Në një letër të madhe (letër mbështjellëse ose 2 harqe të flipchart-it) N e vizatojnë një pemë të madhe me shumë degë e rrëma. Do të duhej të mbetet vend i mjaftueshëm për fletët.

b) Secili N e merr një letër të gjelbër, prej së cilës ai i pret dy fletë peme. Në secilën fletë ai/ajo shkruan një tregim të shkurtër ose (nëse p.sh do të duhej të ndërtohet një pemë-dëshirash për vitin e ri) një dëshirë.

c) Fletët do të ngjiten; N ia lexojnë njëri-tjetrit ato.

7

Gjëegjëza me gjuhë

Qëllimi

Përkrahja e motivimit në të shkruar përmes situatave atraktive të të shkruarit, të cilat mund të merren si gjëegjëzë në vijim të mësimit

1. Fjali me zgjidhje të fjalës

kl. 1–3

20 min.



a) M i ushtron me N në tabelë një ose dy shembuj të fjalive, në të cilat janë të fshehura fjalë zgjidhëse. Për shembull: Nora është në aeroport → Zgjidhja e fjalës «Nëna». N duhet ta kuptojnë rregullën (zgjidhja e fjalës gjendet nëse i bashkon shkronjat e para të fjalëve në fjali).

b) Bashkërisht do të sajohen 1–2 fjali, në vazhdim N do të punojnë vetëm ose në grupe dyshe. Ata do të marrin shirita letrash, në të cilët përpara do të shkruajnë fjalinë gjëegjëzë kurse prapa fjalën e zgjidhur.

c) Në përfundim shiritat e letrave do të shkëmbehen e zgjidhen dyanshëm.

2. Gjëegjëza përshkruese

kl. 4–9

40 min.



Materiali:
Gazeta prej të cilave mund të priten fotografi.

a) N e sjellin një objekt me vete (psh. një çorape leshi), e vizatojnë një objekt ose e zgjedhin një fotografi (një fotografi që e kanë sjellur vetë ose një fotografi nga një revistë, të cilën M e bën gati). Vizatimi, objekti ose fotografia do të ngjitet në një fletë.

b) N e përshkruajnë objektin ose fotografinë e tyre me disa fjali, por pa e përmendur emrin e objektit apo të subjektit të fotografisë. Në vend të kësaj ata flasin për «sendi im» ose «fotografia ime». (Shembull.: «Sendi im është i ngrohtë dhe nga leshi. Në dimër ai i jep dikujt ngrohtësi në këmbë» (Zgjidhja: çorape leshi). «Fotografia ime tregon ujin, i cili bie poshtë nga një breg» (Zgjidhja: Ujëvara).

c) Fotografitë do të ngjiten majtas në klasë, tekstet djathtas. M ia jep secilës fotografi një numër dhe secilit tekst një shkronjë.

d) Detyrë: lexoni tekstet; mundohuni të gjeni fotografinë ose objektin përkatës. Shënoni zgjidhjet (p.sh. 2 – D, 4 – B).

3. Të sajohet fjalëkryqi

kl. 5–9

60 min.



Materiali:
Fjalëkryqi.

a) M analizon me N fjalëkryqe të thjeshta në gjuhën e parë ose të dytë dhe bisedon me ta se sipas cilës «recetë» mund të krijohet një fjalëkryq.

b) N krijojnë sipas kësaj recete fjalëkryqin e vet dhe i shkëmbejnë me njëritjetrin për t'i zgjidhur.

Udhëzime: fjalëkryqe me shkronja latine mund të krijohen pa problem me mjete perkatëse në internet, shiko p.sh. <http://www.xwords-generator.de/> ose <http://www.armoredpenguin.com/crossword/>.

4. Ngjarje ose ritregime me gracka «ngjarje me hile»

kl. 2–9

30 min.



Materiali:
Tregim ose një tekst tjetër si parashtrim.

Modeli bazë është ky: Një paraqitje (një rrëfim, një tekst tematik etj) do të jepet së pari në mënyrë korrekte e pastaj do të jepet përsëri me disa ndryshime, të cilat do të duhej të zbuloheshin nga dëgjuesit/et.

Variantet:

- Ushtrim paraprak me gojë: M e tregon një rrëfim dy herë; herën e dytë ai i ndryshon disa detaje. N duhet të dëgjojnë me vëmendje dhe të shënojnë se çfarë nuk ishte korrekte herën e dytë.
- N e shkruajnë vetë një ritregim mundësisht të saktë, të cilin e njohin të gjithë, ose një tekst nga historia e gjeografisë së vendit të prejardhjes (p.sh. mbi një personalitet, një ngjarje historike ose mbi një qytet). Në këtë tekst i futin në mënyrë të vetëdijshme 2–3 pasaktësi të vogla. Në vazhdim tekstet do të lexohen ose do të shkëmbehen; N e tjerë duhet t'i zbulojnë gabimet.
- Krahazo me variantet e tjera me ritregimet nr. 18.3.

Teknikat dhe strategjitë për fazat e ndryshme të procesit të të shkruarit

Qëllimi

N do të duhej të përkrahen, para të shkruarit të mirëfilltë (dhe ende të pangarkuar nga kërkesat gjuhësore) në mënyrë asociative t'i zhvillojnë idetë dhe t'i rendisin. Është me rëndësi që M ta sqarojë dhe ta paraqesë bukur rrjedhën.

Tri rrjedha, për t'i gjetur dhe renditur idetë:


1. Cluster

kl. 2-9

20 min.



Materiali:
Fletë A3- ose A4



Kjo rrjedhë është e përshtatshme që në mënyrë asociative p.sh. për t'i gjetur idetë për një tregim ose për një tekst fantazi. M e bën një shembull në formë të skicës së ilustruar anash dhe sqaron: Merre një fletë (A4 ose A3 diagonal). Shkruaje në mes titullin ose temën, për të cilën duhet të shkruash. Qarkoje këtë titull.

Shkuaj rreth e qark ide të cilat të vijnë në mendje për këtë temë; qarkoju gjithashtu edhe këto. Nga mjaft ide dalin linja pasuese dhe rrethe për mendime të tjera; mund të ndërtohet një zinxhir i tërë i mendimeve. Nëse ti ke vështirësi që klasterin ta bësh në gjuhën tënde amtare, mund të përdorësh nocione edhe nga gjuha e shkollës. Pas gati pesë minutash e vështron grumbullimin e ideve tua dhe i nënvizon me ngjyra dhe numra, cilat ide do t'i përdorësh në tekstin tënd dhe në çfarë renditje duhet të ndodhë kjo.


2. Mind-Map

kl. 4-9

20 min.



Materiali:
Letër e formatit A3 ose A4



Kjo rrjedhë është para së gjithash për tekstet tematike, për ta strukturuar temën. Udhëzimi: tërhiqi disa linja të trasha dhe shkruaj mbi to nëntema të rëndësishme, aspekte ose ide, të cilat të bien ndër mend për temën. Nga këto linja të trasha mund të degëzohen fjali të varura me ide të tjera. Nëse ke vështirësi që mind-map-in

ta bësh në gjuhën tënde amtare, mund ta përdorësh edhe gjuhën tënde shkollore. Pas disa minutash e vështron mind-map-in tënd dhe shënon me numra dhe ngjyra, cilën pjesë të aspektit ose cilën pjesë të temës dëshiron ti ta trajtosh dhe cilën temë të pjesshme në vazhdim.

3. Placemat


kl. 4–9

25 min.



Material:
Fletë A3- ose A4

Një rrjedhë e mirë që në grupe treshe ose katërshe të gjenden ide psh. për një referat ose për një tekst tjetër të përbashkët. Udhëzimi: nga 3–4 N ulen rreth një tavoline dhe e marrin një fletë A3. Kjo do të ndahet në fusha. Në fushën e mesme do të shkruhet titulli gjegjësisht tema. Gjatë afër pesë minutash secili nxënës shënon në fushën e tij ide dhe pika të rëndësishme



për temën e përbashkët. Në vazhdim N i paraqesin mendimet e tyre dhe i shënojnë me ngjyrë dhe me numra gjithçka që në vazhdim duan të përdorin në tekstin ose në referatin e tyre. Në një hap tjetër ata i shënojnë në një fletë tjetër me radhë nënkapitujt e veçantë ose mendimet kryesore për referatin ose tekstin e tyre. Me këtë ata kanë përpunuar një strukturë solide për përfundimin e tekstit.

9

Të planifikohet ndërtimi i tekstit (krh. edhe 16, Nxitje për ndërtimin e tekstit)


Qëllimi

N i njohin dy teknika, përmes të cilave mund të përballojnë më lehtë ndërtimin e një teksti. (Ndarja në hyrjen, pjesën kryesore dhe përfundimin; rrjedhën korrekte të kohës), kjo edhe si udhëheqje e mëtejshme e teknika-ve në 8 (Cluster, Mind-Map, Placemat).

1. Puna me rreze kohore

kl. 2–7

20 min.



a) M vizaton një rreze kohore (shigjetë e gjatë; shiko ilustrimin) në tabelë ose në projektor dhe sqaron N se ajo u ndihmon atyre për të ndërtuar në mënyrë të qartë një tekst.

b) Për ta konkretizuar do të bëhet një shembull. Në këtë rast do të duhej të bëhej fjalë për një temë e cila ka një rrjedhë të qartë (p.sh. «Pushimet e mia verore», «Fundjava e kaluar», «Jeta e Nënës Tereze». Më pak të përshtatshme janë temat refleksive ose përshkruese si p.sh. «Mendimet e mia për temën pagja»; krahaso këtu më shumë skemën pasuese tripjesëshe).

c) M i përpunon me N se përmes cilave fjalë dhe shprehje do të mund të shënohen njëra pas tjetrës shkallët e ndryshme pasuese të një tregimi. «Në fillim, pastaj, ashtu që, pas kësaj, në ditën tjetër. përfundimisht, në fund të fundit» etj. Me këtë do të ndërtohet njëkohësisht një leksik përkatës në gjuhën amtare.

d) N e marrin një temë të thjeshtë me orientim veprimi (p.sh. «Rrjedha e ditës sime») dhe një fletë A3. Në këtë fletë vizatojnë një rreze kohore dhe shënojnë secilin stacion të veprimit. Në vazhdim fletët do të shikohen dhe diskutohen bashkërisht.

e) Në vazhdim N shkruajnë tekstin e tyre në prozë ku ata natyrisht bazohen në stacionet e rrezes kohore.

2. Puna me një skemë për renditjen dhe ndërtimin e një teksti

kl. 4–9

20 min.



a) M sqaron së pari se shumica e teksteve lejojnë të renditen në tri pjesë: hyrje/vështtrim – pjesa kryesore (përmbajta themelore) – përfundimi/përmbledhja/vështtrimi më tutje. Kjo do të duhej të ndodhë mundësisht në mënyrë konkretizuese (artikull nga gazeta, tekste të shkurtra letrare, punime të suksesshme të nxënësve/nxënësve).

hyrje
pjesa kryesore
përfundimi

hyrje	pjesa kryesore	përfundimi

b) M skicon skemën (shiko ilustrimin) në tabelë ose në projektor dhe e paraqet bashkë me klasën, në bazë të një teme. Shembuj me tema të përshtatshme: Përshkrimi i vendit prej nga vjen familja ime; Shënime nga udhëtimi në ...; Mendimet e mia për temën «Jeta në dy kultura dhe gjuhët».

c) N e marrin një temë (shembuj shih më lart) ose zgjedhin një temë të lirë. Ata e marrin një fletë, e ndajnë në tri fusha hyrja – pjesa kryesore – përfundimi dhe shkruajnë fjalë përmbledhëse për secilën pjesë. Posaçërisht do të ishte mirë nëse N së pari e zbatojnë një procedurë nga nr 8 (Cluster, Mind-Map, Placemat) për t'i mbledhur idetë e para.

d) Diskutimi i përvojave me skemën. Si do të mund të shkojë puna më tutje? Nëse është e mundur do të duhej që ky rast i të shkruarit të çohet deri në fund.

Qëllimi

N do të duhej të mësojnë të vendosin tituj të qartë dhe të përshtatshëm dhe tekstet e tyre t'i ndajnë në pjesë të qarta. Titulli, mestitulli dhe ndarja e tekstit në pjesë japin një kontribut të rëndësishëm për atraktivitetin dhe të lexuarit e një teksti. Qëllimit të njëjtë i shërbejnë ilustrimet dhe forma e prezantimit (Layout); edhe me këto elemente do të duhej që N të mund të mbledhin përvoja.

1. Të gjenden tituj precizë dhe atraktivë: ide didaktike

kl. 3–9

20 min.



Materiali:
Tregime të ilustruara, lajme të gazetave ose të ngjajshme (shiko djathtas).

Variantet:

- M e lexon një tregim kreativ. Ai pyet se cili titull do t'i përshtatej këtij teksti. Secili N shënon në shirita letre një ose dy propozime titujsh. Propozimet do të diskutohen. Cilët janë (pse) atraktivë, cilët (pse) më tepër të mërztishëm?
- M e paraqet synimin (fiktiv) të bëj një pllakat si reklamë turistike, një fletëpalosje ose një prospekt për vendin e prejardhjes (ose për kryeqytetin e tij, bukuritë e tij natyrore etj.). Çka do të ishte një titull atraktiv ose një slogon për këtë pllakat? (Nëse koha mjafton, ideja do të duhej natyrisht të zbatohet.)
- M e shpërndan një tregim me ilustrime, një informacion nga gazeta ose një tregim të shkurtër pa titull. Në grupe dyshe ose individualisht N duhet të gjejnë titullin e qartë dhe të përshtatshëm. Propozimet do të shkruhen në shirita letre dhe do të diskutohen.
- Diskutim me klasën ose me grupe nivelesh rreth pyetjes: për cilin titull do të shkruanit ju me qejf një tekst? Mendoni tituj dhe tema interesante. Propozimet do të diskutohen, mblidhen dhe sipas mundësive edhe do të konkretizohen.
- Prej klasës së katërt.: M mbledh (mundësisht bashkë me klasën) shembuj nga titujt atraktivë të librave. Në mënyrë plotësuese ai sajton disa tituj të mërztishëm si «Susi, kjo vajzë e dashur», «Poezi lulesh». Titujt do të diskutohen, N përpiken të gjejnë se çfarë e bën një titull interesant dhe të mirë dhe gjegjësisht të mërztishëm.

2. Të renditet një tekst me mestituj dhe pjesë

kl. 3–9


30 min.



Materiali:
Tekste të parapërgatitura (shiko djathtas)

Variantet:

- M i ka përgatitur dy tekste me nga një faqe A4 (kopje): Teksti A nuk ka titull dhe mestituj dhe nuk është ndarë ose gati hiç në pjesë. Teksti B (p.sh. një tekst tematik mbi një vend ose një kafshë) ka një titull të qartë dhe është ndarë në pjesë me mestituj të mirë. Diskutim: pse teksti B është më i lehtë për lexim; çfarë ndikojnë mestitujt dhe ndarjet? Si lejon kjo të ngritet edhe më lart (p.sh. përmes ilustrimeve)?



- M shpërndan një tregim me ilustrime (4–5 ilustrime) Detyrë: gjeni në grupe dyshe një titull atraktiv për tërë tregimin dhe nga një nëntitull për secilin ilustrim!
- M shpërndan një tekst të pandarë në pjesë, pa titull (maksimalisht 2/3 faqe). Detyrë: kërkoni një titull për tekstin, ndajeni atë në pjesë dhe formuloni mestitujt!
- M shpërndan një tregim të prerë në shirita letre (për një pjesë një shirit letre). Detyrë: gjejeni renditjen e saktë, kërkoni për secilën pjesë një mes-titull; ngjitni shiritat e letres në një fletë dhe shkruani në mënyrë plotësu-ese titullin dhe mestitullin!
- M ua jep një temë N si psh.: «Referat mbi kryeqytetin tonë», «Një perso-nalitet i rëndësishëm nga kultura jonë» ose «Jeta ime mes dy kulturave». Detyrë: Nëse ju për këtë do të duhej të shkruanit një tekst ose një refe-rat: çfarë titulli dhe mestitulli do të zgjidhni për tërësinë ose për secilën pjesë?
- Detyrë (event. në vazhdim të propozimit të mësipërm): shkruani një tekst, ndajeni atë me nëntituj të përshtatshëm në së paku katër pjesë!

3. Ilustrimet dhe formatimi (Layout) si mjete modelimi

kl. 3–9

30 min.



- Nxitjet e mësipërme lejojnë pa probleme për t'i zgjeruar pyetjet: Si do të mund ta bëjmë tekstin edhe më të kuptueshëm e më të këndshëm për ta lexuar përmes ilustrimeve? Çfarë paraqitje/çfarë formatimi do të ndihmonte këtu?
- Përpjekjet personale dhe eksperimentet (edhe në kompjuter) do të duhej patjetër të futen në punë. Përpos ideve të theksuara, janë të përshtats-hme këtu edhe p.sh. fletë pune, të cilat N në vazhdim të temave nga fusha e teksteve tematike ose në referate i bëjnë për njëri-tjetritin.

11

Teknikat për përpunim dhe vetëkorrekturë

Qëllimi

N duhet të mësojnë që tekstet e tyre t'i përpunojnë dhe t'i organizojnë. Këtu bëhet fjalë në njërin anë për aspekte përmbajtësore (kuptueshmë-ria, logjika e ndërtimit, atraktiviteti për lexuesit/et) dhe në anën tjetër, për aspektet formale (drejtshkrimi, sintaksa, format korrekte). Përpunimi dhe organizimi i kujdesshëm i teksteve e përkrah kompetencën në shkrim dhe formën standarde në gjuhën e parë si dhe vetëdijen për gjuhën e shkruar. Format e përpunimit të përbashkët janë me përparësi në raport me përpunimin individual, sepse e përkrahin vetëdijen për gjuhën në mënyrë interaktive dhe i shfrytëzojnë paralelisht resurset e dy ose tre nxënësve.

1. Kompetenca në të shkruar: Tekstet të përpunohen bashkërisht

kl. 2–9

30 min.



Materiale:
Fjalori i drejtshkrimit

Ky proces ndëraktiv i përpunimit të tekstit është i njohur për shumë N nga mësimi i rregullt. Është shumë i përshtatshëm edhe për mësimin në gjuhën amtare ngase e përkrah kompetencën në gjuhën standarde dhe vetëdijen ndaj së njëjtës.

- Parakusht është që N të kenë shkruar një tekst (mundësisht jo më të gjatë se një faqe). Kush e ka përfunduar tekstin e tij e mëson së pari që ta lexojë mirë. Pastaj ai/a jo kërkon një ose dy partner/e që t'i përpunojë me ta këto skica. (Varianti: M i formon ekipet redaktuese.)
- Tek ekipet redaktuese vjen njëri pas tjetrit nga një fëmijë. Ai/a jo ua lexon së pari tekstin si tërësi të tjerëve dhe i paraqet tri pyetjet vijuese (pyetjet

të shënohen në tabelë ose në shirita letre ose të jepen si kopje): A e keni kuptuar ju tekstin? Çfarë duhet të formuloni unë më qartë? Çfarë është mirë çfarë ende jo aq? Fëmija merr shënime për shpërfaqjet.

c) Pastaj teksti do të përpunohet fjali për fjali. Pyetjet këtu: a është fjalia e kuptueshme? A është gjuhësisht korrekte (format, ndërtimi i fjalisë)? A ka fjalë më të mira? A është i saktë drejtshkrimi? (të shfrytëzohet fjalori!)

d) Pastaj vjen fëmija tjetër në rend me tekstin e tij.

e) Kur të jenë diskutuar të gjitha tekstet në grup, atëherë N e bëjnë përpunimin dhe e shkruajnë versionin e përmirësuar të tekstit të tyre. Ky korrigjohet në fund nga M dhe shoqërohet me një koment. Në vazhdim duhet që tekstet të jenë të arritshme për nxënësit tjerë, krahaso këtu më poshtë nr. 12 (referim adresash)

2. Teksti të përpunohet vetë (dhe pastaj të diskutohet me M)

kl. 2–9

30 min.



Materiali:
Fjalori drejtshkrimor

Përpunimi individual është para së gjithash aktual kur nuk ka mundësi për konfrontim të përbashkët me tekstet (p.sh. tek tekstet, të cilat shkruhen në shtëpi). Edhe në këto raste duhet të shfrytëzohen shpërfaqjet e lexuesve të jashtëm (prindërit, vëllezërit/motrat, mësuesi/ja etj).

Është me rëndësi që N për të përpunuar një tekst në mënyrë individuale të kenë një listë me pyetje dhe impulse konkrete e ndihmëse:

- A do të mundja ta riformuloja titullin e tekstit tim ashtu që të zgjojë më shumë interesim dhe kureshtje ose ta ofrojë një informacion më të qartë të përmbajtjes?
- A ka teksti im një ndërtim të qartë (hyrje/vështtrim i përgjithshëm, pjesa kryesore, përfundimi /përmbledhja); a është i qartë ndërtimi? A kam mbetur në kuadër të temës?
- A fillon teksti me një fjali interesante ose informative, që ta shtojë qejfin për ta lexuar më tutje; a do të mundja unë ta bëj këtë më mirë?
- A kam zgjedhur fjalë të qarta dhe të sakta; a mos kam shumë përsëritje?
- Me cilat forma (p.sh. format kohore të foljeve) nuk jam i sigurtë; kë mund ta pyes? (Pasiguritë të shënohen dhe eventualisht të sqarohen me M).
- A është teksti im në rregull sa i përket drejtshkrimit; a i kam sqaruar pasiguritë përmes fjalorit drejtshkrimor? (Këtu, N natyrisht duhet të jenë të pajisur me një fjalor drejtshkrimor në gjuhën e tyre dhe të udhëzohen me kujdes për përdorimin e tij (teknikat e kërkimit, event. veçoritë e renditjes së shkronjave në krahasim me gjuhën e shkollës etj.)


Qëllimi

N duhet të dinë se edhe në mësimin e gjuhës amtare, të shkruarit është një akt komunikimi. Ata duhet të mësojnë që tekstet e tyre të shkruara në gjuhën e parë t'i modelojnë dhe prezantojnë në forma të ndryshme përkatëse. Për këtë arsye M duhet që tek secila detyrë në të shkruar mundësisht të theksojë adresat e referimit dhe/ose të propozohet një produkt (p.sh. libër, pllakat, videoclip) që do të krijohet. Ky adresim dhe qëllim ose orientim tek produkti e rrit motivimin në të shkruar dhe motivimin, që të bëhet mund edhe në aspektin formal dhe krijues: N e dinë se ata nuk shkruajnë thjeshtë për mësimdhënësin, por tekstet e tyre do të jenë për një publik të vërtetë.

1. Për kë mund të shkruhet: Adresuesit/et e mundshëm te teksteve

Materiali:
Sipas variantit (shih djathtas)

- Për klasën e vet ose grupin: tekstet (p.sh. tregimet, poezitë) t'i lexohen njëri-tjetrit në mënyrë të dyanshme, eventualisht të ndarë në 2–3 rrethe leximi.
- Për klasën e vet ose për grupin në kuadër të referateve, p.sh. për tema të caktuara për vendin e prejardhjes, event. me përkrahje të power-point ose të pllakatit.
- Për nxënësit/et më të rinj: N e vjetër shkruajnë tregime ose e bëjnë një libër për N e rinj ose për vëllezërit-motrat në shtëpi.
- Për adresuesit/et jashtë shkollës: Kartolinë urimi për Ditën e Nënave ose për Vitin e Ri; letra për të afërmit apo të njohurit në vendin e prejardhjes; kërkesa me shkrim (letër ose email) ambasadës së vendit të vet ose ndër-marrjeve të atjeshme.



- Letërkëmbim (letra ose email-e) me një klasë në vendin e prejardhjes ose një klasë me gjuhë amtare në vendet e tjera.
- Për bashkënxënësit në shkollë: të nxitet që të krijohet një gazetë muri me kontribute të shkruara në gjuhën e parë (me përmbledhje të shkurtër në gjuhën e shkollës). Variante: receta ose libër shumëgjuhësor. Krahso këtu edhe nxitjet e nr. 21.
- Për një takim me të rriturit nga kultura e vet (mbrëmje me prindër, mbrëmje kulturore etj.): të shkruhen dhe të mësohet si të paraqiten poezi, skeçe, shakara ose tregime tepër të shkurtëra.

2. Format e paraqitjes dhe mediat për tekstet e shkruara

Materiali:
Sipas variantit (shih djathtas)

- Format tradicionale: Teksti në fletoren e hartimit (jo edhe aq motivuese se s'ka adresë referimi)
- Përmbledhje tematike e teksteve për një temë (p.sh. tregime për pushimet, shakara, receta): një N e krijon titullin e fletës, tekstet do të lidhen/ngjiten, në mënyrë që të mund (si një libër biblioteke) të huazohet. Krahso këtu edhe nr. 5.3 dhe 5.4
- Krijimi si pllakat, poster ose kollazh në formatin A3 ose më të madh. Është i përshtatshëm edhe për temat nga gjeografia, historia dhe në raport me referatat.

- Krijim artistik p.sh. poezitë: në letër me ngjyrë, eventualisht në formë të fletëve të prera dhe të zbukuruara. Event. të zgjerohet në një konkurim krijues.
- Mediat elektronike: Eksperimente me sms dhe email në gjuhën amtare.
- Pjesëmarrje në fore diskutimesh, blog, chatrooms etj. në gjuhën amtare. Krijimi i një uebfaqeje, në të cilën edhe persona të tjerë ose klasat e gjuhës së njëjtë mund të vendosin tekstet e tyre.

3. Forma të tjera të zbatimit dhe të prezentimit të teksteve personale

- Zbatimi përmes përkrahjes së mediave si lojë dëgjimi, audio-file, reportazh, viedoclip, podcast, prezentim powerpoint etj.
- Zbatimi përmes formave skenike: recitim (poezish), pjesë teatrale, skeç, valle, rap etj.

13 Komenti për fletët e punës të nxënësve/eve FP 1 + 2

Qëllimi

Të dy fletët e punës FP1 dhe 2 janë koncipuar direkt për dorën e nxënësve/eve. Ato duhet t'u ndihmojnë gjatë të shkruarit të teksteve dhe të përkrahin pavarësinë e tyre përmes këshillave dhe nxitjeve konkrete. Të dy fletët e punës mbështeten fort në strategjitë e të mësuarit dhe në procedurat të cilat janë të njohura për shumë nxënës/e nga tekstet gjuhësore të shkollës së rregullt fillore. Ato kontribuojnë që të ofrojnë metodikën e gjuhës amtare me atë të mësimit të rregullt. Fletët e punës i sqarojnë nxitjet e paraqitura didaktike, por kurrsesi nuk i zëvendësojnë ato.

Hyrje: Elemente të përgjithshme

Sa i përket kërkesave të nivelit gjuhësor të dy fletët janë të kuptueshme dhe mund t'u jepen nxënësve/eve nga klasa e katërt. Për nxënës/e më të rinj është e këshillueshme të trajtohen vetëm pika të zgjedhura, të cilat sqarohen gojarisht dhe paraprakisht. Varësisht nga gjendja dhe niveli i të kuptuarit, kjo procedurë (kufizimi në pika të veçanta, sqarimi paraprak) është e vlefshme edhe tek nxënësit/et më të vjetër.

Tek hyrja për fletët është me rëndësi të kihet kujdes për paraqitje sa më të qartë. Vetëm atë çka nxënësit/et e kuptojnë dhe e bëjnë konkretisht, do të jetë e përdorshme gjatë punës së tyre të pavarur. Pas hyrjes, fletët duhet t'u jepen nxënësve/eve si kopje, me të cilat mund të punojnë edhe në shtëpi. Është mirë që fletët të mësohen jo njëra pas tjetrës por me një distancë prej 2–3 javësh t'u jepen dhe të lihet t'i provojnë.

Shumë pika, të cilat janë përmbledhur thuktë në dy fletët e punës, gjejnë ushtrime konkrete dhe të thelluara dhe nxitje në kapitujt tjerë të këtij teksti (para se gjithash në nr. 8–12). Nëse këto nxitje janë paraqitur paraprakisht, kjo natyrisht se e lehtëson edhe hyrjen në të dy fletët dhe të kuptuarit e tyre nga nxënësit/et.

Për fletën e punës FP 1
«Një tekst të planifiko-
het, përmbledhet, për-
punohet – hap pas hapi»

Më së miri është që të gjashtë hapat e kësaj flete pune të provohen përmes një detyre konkrete në të shkruar.

Këtu duhet të bëhet fjalë një herë për një tekst tematik (p.sh. për një detyrë si «Mblidhni informacione mbi një qytet të caktuar ose një vend (ose mbi një personalitet) nga vendi ynë i prejardhjes; të shkruhet për këtë një tekst prej 1 ½ e faqes; prezentoni tekstin në vazhdim si referat prej 5–10 minutash».

Herën e dytë të gjashtë hapat do të provohen përmes një teksti letrar ose një teme e mbështetur në fantazi («Ne sajojmë poezi për vendin tonë», «Aventura ime interesante e pushimeve», «Një tregim gënjeshtre»).

Me rëndësi është që të gjashtë hapat të diskutohen konkretisht dhe të provohen. Kjo kërkon kohë, por e vlen patjetër, sepse nxënësit/et mësojnë shumë për punën e tyre të ardhme.

Për ta thjeshtuar mund të diskutohen në një rreth të parë vetëm titujt e shkruar të gjashtë hapave me shkronja të trasha. Nënpiakat pasojnë në një rreth të dytë përmes fletës së punës.

Për fletën e punës FP 2
«Të merremi me proble-
met në të shkruar»

Kjo fletë pune është menduar si fletë sqaruese për FP 1. Është me rëndësi që para se të shpërndalet të diskutohet me nxënësit/et, ku kanë ata probleme nganjëherë në të shkruar dhe çka mund të bëjnë kundër tyre. Në vazhdim FP 2 do të lexohet dhe diskutohet.

Edhe këtu është natyrisht optimale, nëse mjaft këshilla provohen dhe përvojat e mbledhura në vazhdim diskutohen. Kjo e thellon përvetësimin dhe kontribuon që nxënësit më vonë fletën ta përdorin në mënyrë kompetente.

Një tekst të planifikohet, përmbledhet, përpunohet – hap pas hapi

Fletë pune për nxënësit/et

Hapi 1

Gjej ide të mira për temën tënde!

Mundësitë:

- Merre një fletë ose copëza të ndryshme letrash të vogla. Shëno gjithçka që të bie ndër mend për temën. Nëse për ty është më e lehtë, mundesh që shënimet t'i bësh edhe në gjuhën e shkollës.
- Nëse ke kohë: bisedo me njerëz të ndryshëm mbi temën. Shënoji idetë e tyre.
- Bëje një mind-map ose një cluster, nëse tashmë i njeh këto teknika.



Hapi 2

Renditi idetë, planifiko ndërtimin e tekstit tënd.

- Shikoj shënimet ose copëzat e letrave me radhë. Mëshhoji vijë atyre që nuk të nevojiten.
- Merre një letër dhe ndaje në tri fusha vijuese: hyrje/ vështrim i përgjithshëm – pjesa kryesore (fusha e gjerë!) – përfundimi/përmbledhja
- Shkruaj në secilën fushë idetë të cilat i përshtaten asaj fushe. Mendo se çfarë mungon ende, plotësoje!
- Rri aq gjatë te ky hap derisa mund ta parashohësh përafërsisht tekstin tënd/tregimin tënd.
- Mendohu gjithashtu se si do ta krijosh tekstin tënd (në një fletë, në kompjuter, përmes ilustrimit...).

Hapi 3

Shkruaje një version të parë të tekstit (skicë).

- Shkruaje tekstin.
- Lexoje krejt skicën tënde. A është në rregull ndërtimi? A do t'i ndryshosh që tash disa fjalë, forma ose fjali?

Hapi 4

Gjeje një titull atraktiv dhe fillim.

- Me një titull të mirë mund t'ua zgjosh kureshtjen lexuesve/eve ose dëgjuesve/eve. «Ndihmë unë po fundosem» tingëllon për shembull më interesant se «Aventurat e pushimeve të mia»
- E njëjta gjë vlen edhe për fjalinë e parë ose pjesën e parë të tekstit: këtu mund të futësh interesim dhe kureshtje. Në një tregim, tonin ia jep një hyrje e papritur, interesante, kurse një teksti tematik, një informacion i qartë.
- Tek fjalitë dhe referatat e gjata është me rëndësi të vendosen mestituj të mirë dhe informativ. Ata u ndihmojnë lexuesve/eve që të ruajnë një vështrim të përgjithshëm.

Hapi 5

Përpunoje(ni) skicën.

- Kjo ndodh më së miri në grup dysh ose tresh në një «konferencë shkrimi». Në këtë formë ju mund ta këshilloni njëri-tjetrin reciprokisht dhe të ndihmoni më tutje. Por edhe vetë mund ta përpunosh tekstin tënd. Tek përpunimi janë të nevojshme pyetjet vijuese:
 - A është teksti im si tërësi i kuptueshëm dhe interesant? Çfarë duhet të formuloj më qartë? Çka është mirë, çka jo aq mirë? A i jam pëmbajtur temës?
 - A ka teksti im një ndërtim të qartë (hyrja/vështimi i përgjithshëm, pjesa kryesore, përfundimi/përmbledhja); a është rrjedha e qartë? A mos kam shkruar jashtë temës?
 - A do të mundja ta riformuloja titullin e tekstit tim ashtu që të zgjojë më shumë interesim dhe kureshtje ose që ai të ofrojë një informacion më të qartë për titullin.
 - A fillon teksti me një fjali interesante ose informative, që e shton qejfin për lexim të mëtejshëm; a mundja ta bëja këtë më mirë?
 - A është secila fjali e kuptueshme dhe korrekte në aspektin gjuhësor (format, ndërtimi i fjalisë)? Shënoji pasiguritë dhe sqaroj ato me mësimdhënësin ose me dikë që i njeh këto gjëra.
 - A kam zgjedhur fjalë të qarta dhe të sakta; a mos kam tepër shumë përsëritje? A është në rregull drejtshkrimi (të përdoret si mjet ndihmës fjalori i drejtshkrimit!)?



Modeloje versionin përfundimtar të tekstit.

Hapi 6

- Shiko që teksti yt sa i përket paraqitjes të jetë tërheqës për lexuesit/et ose të jetë interesant për dëgjuesit/et!
- Eksperimento edhe me forma të reja (krijim me ilustrime ose si kollazh, në kompjuter, si tekst-dëgjues (audio-file) etj.

Kjo fletë të tregon ty se si mund t'i zgjidhësh disa probleme në të shkruar.


- Nëse ti nuk ke ide se çfarë do të mund të shkruash, ose nëse ke vështirësi me ndërtimin dhe ndarjen e tekstit, atëherë shiko fletën e punës FP 1!



Problemi 1

Unë kam vështirësi të shkruaj në gjuhën time amtare.


- Tek mbledhja e ideve ose tek skica mund të përdorësh fjalë edhe nga gjuha shkollore (p.sh. gjermanisht), nëse për ty është më e lehtë.
- Nëse ke vështirësi me dialektin ose gjuhën e shkruar në gjuhën amtare ose me format korrekte: Shkruaj në skicë ashtu si ti mundesh. Diskutoje skicën pastaj me mësimdhënësin ose me dikë i cili e zotëron gjuhën e shkruar. Lejo që të të sqarohet se çfarë duhet të ndryshohet dhe pse.
- Ndoshta mund të merresh vesh që ti të shkruash vetëm një tekst të shkurtër, por mundësisht korrekt, ose që ti t'i përpunosh pesë fjalitë e para mundësisht në mënyrë korrekte.
- Për drejtshkrim do të duhej të shfrytëzosh një fjalor në gjuhën tënde.



Problemi 2

Unë nuk po gjej një fillim interesant ose hyrje atraktive.


- Është me rëndësi, që para fjalisë së parë, teksti yt të ketë një titull interesant! Referatat dhe tekstet e gjata do të duhej gjithashtu t'i ndash përmes nëntitujve.
- Tek një tekst tematik ose tek një referat, në fillim, qëndron një vështrim i shkurtër mbi përmbajtjen e tekstit. Ai u ndihmon lexuesve/eve ose dëgjuesve/eve për t'u orientuar më mirë.
- Edhe një tregim ose një përjetim mund të fillojë me një formë të një vështrimi të përgjithshëm: «Unë dua t'u tregoj juve, se si unë njëherë...», «Në rrëfimin tim bëhet fjalë për ...».
- Por një tregim mund të fillojë edhe nga «brendia e mesit», që nganjëherë zgjon shumë kureshtje: «Unë shtrihesha si i vdekur në tokë. Çfarë kishte ndodhur? Ngadalë më kujtohej ...»
- Edhe një pyetje drejtuar lexuesve/eve ose dëgjuesve/eve mund të krijojë një fillim të mirë: «A dëshironi të dini se çfarë përjetova verën e fundit? Dëgjoni mirë! Ishte në një ...».



Problemi 3

Unë nuk e di se si dhe çfarë duhet të shkruaj më tutje.


- Lexoja dikujt ose tregoja dikujt se çfarë ke shkruar deri tash. Diskutoje më këtë person se si mund të shtjellohet teksti yt më tutje.
- Tek një tekst tematik ose referat: Mendoje një aspekt të ri të temës sate ose një nëntemë të re, të cilën nuk e ke trajtuar ende.
- Tek një tregim: Mendohu se çfarë dëshirojnë të dinë lexuesit/et edhe më saktësisht. Shkruaj diçka për këtë: («Tomi u shtri në krevat dhe fjeti.» → «Ju doni të dini se si dukej krevati i Benit dhe dhoma? Këtë mund t'ua them juve me kënaqësi: ...».)
- Lexoje fjalinë e fundit të tekstit tënd. Shkruaje një fjali tjetër, në të cilën e merr një fjalë nga fjalia e fundit: «Tomi u shtri në krevat dhe fjeti.» «Ai fjeti thellë, derisa papritur u hodh përpjetë, sepse iu kujtua, se ...».)



Problemi 4

Unë nuk gjej përfundim të mirë për tekstin tim.


- Tek një tekst nga fusha e dijeve është shpesh mirë që në fund të shkruhet një përmblendje («Pikat më të rëndësishme të temës sime janë ...».)
- Është shpesh mirë që në fund të tekstit të jepet një mendim personal: «Mua më pëlqen në këtë tregim/te kjo temë veçanërisht, ...», «Sipas mendimit tim ...».
- Në fund mund t'i drejtohesh edhe lexuesve/eve: «Unë shpresoj që ishte e qartë se çfarë desha t'u them», «Si do të ishit sjellur ju këtu?».



Problemi 5

Ndihmë, teksti im është tepër i shkurtër! (Shiko më lart edhe njëherë tek problemi 3!)

- Tek tregimet: Sajoje një figurë plotësuese (p.sh. një mace), e cila herë pas here del në sipërfaqe.
- Shkruaj tek disa fjali të tekstit tënd një zgjerim ose një fjali plotësuese (Shembull: «Atëherë isha ende shumë i vogël» → «Atëherë, para rreth pesë vjetësh, unë isha shumë i vogël. Unë isha më së shumti gjashtë vjeç dhe shkoja së pari tek në kopsht parashkollor.»)
- Zgjerorje përfundimin e tregimit tënd. Tek një tekst tematik p.sh. me një përmblendje të mirë, tek një tregim me një qëndrim personal.



**Nxitje për përkrahjen e aspekteve
të pjesshme të të shkruarit**

Nxitje për punë në leksik I: puna me fushat e fjalëve, vënia në gatishmëri e mjeteve të zgjeruara gjuhësore

Qëllimi

Leksiku i gjuhës amtare i shumë nxënësve/eve në emigrim është fort i kufizuar: përmbajtësisht në çështje me rëndësi të jetës familjare, gjuhësisht në format dialektore. Mësimi në gjuhën e prejardhjes qëndron para detyrës sfiduese, që të zgjerojë leksikun e fëmijëve dhe të rinjve (ashtu që ai të përfshijë edhe aspekte diferencuese) dhe të japë edhe forma gjuhësore standarde. Është me rëndësi këtu të vendoset se cilat fjalë dhe shprehje nxënësit/et duhet t'i zotërojnë në mënyrë aktive (aktiv ose leksiku produktiv) dhe cilat njëherë vetëm t'i kuptojnë (receptiv ose leksiku i të kuptuarit). Të parat duhet të ushtrohen dhe përdoren intenzivisht, tek të fundit mjafton edhe për ta siguruar kuptimin. – Nxitjet dhe ushtrimet vijuese e përkrahin punën në leksik dhe tek mjetet tjera të zgjeruara gjuhësore në nivele të ndryshme.

1. Të mblidhen tjalë për një temë, puna me fushat e fjalëve

kl. 1–9


20 min.



Materiali: Event. fletë A2 dhe fletëza të vogla (Post-it)

Mbledhja dhe shënimi i fjalëve për një temë është një metodë e mirë për t'i përdorur njohuritë dhe resurset e përbashkëta të nxënësve/eve dhe të M. Procedura është vërtetuar në të gjitha nivelet e moshave dhe në format e ndryshme metodike. Kjo ofron mundësi optimale, për t'i theksuar në mënyrë të vetëdijshme format standarde ose gjuhësore të shkruara (në raport me ato dialektore) dhe për t'u konfrontuar me dallimet në leksik në të dy format. Fjalët që më së shumti përdoren nga një përmbledhje tematike mund të zgjidhen edhe për ushtrimet në drejtshkrim. Një nivel i zgjeruar paraqet një përmbledhje të mjeteve të zgjeruara gjuhësore (fillimet e fjalive, përdorimi specifik i teksteve), krahaso këtu me nr. 15.

Me rëndësi: Nëse një nxënës/e e di një fjalë vetëm në gjuhën e shkollës, por jo në gjuhën amtare, ai/ajo mund ta thotë ose ta shkruajë në këtë formë. Me këtë krijohet një situatë autentike, për t'i pyetur nxënësit/et e tjerë ose për ta konsultuar fjalorin.



Shembuj:

• Mbledhja e fjalëve («Çfarë di unë krejt») (prej kopshtit parashkollor):

Nën udhëheqjen e mësimitdhënësit, nxënësit i shënojnë se cilat fjalë u bien ndër mend në gjuhën e tyre të parë për temat si kafshët, bimët, banesa, shkolla etj. Sipas rastit M ua paraqet formën korrekte të gjuhës standarde dhe/ose i shënon fjalët më të rëndësishme në fletore. Me rëndësi: nuk duhet të mblidhen vetëm emrat, por edhe foljet dhe mbiemrat. Niveli zgjerues: a) Me fjalë të formohen fjali të shkurta; event. të shkruhen. b) të shkruhet një tekst, në të cilin së paku 5 (ose më shumë) fjalë vijnë në shprehje nga mbledhja e fjalëve; këto fjalë të shënohen me të kuqe (ky është një variant i tregimeve skelë nga nr. 4).

- **Mbledhja e fjalëve për një ilustrim**

(prej kopshtit parashkollor – shkalla e lartë:

Si pikënisje shërben një ilustrim me shumë detaje (i nxjerrë nga një temë aktuale nga tekstet tematike, p.sh. një pllakat nga vendi i prejardhjes ose ilustrim nga një shesh lojërash. Për nivelin e mesëm dhe të lartë janë të përshtatshme ilustrime/fotografi që kërkojnë një leksik specifik). Në grup ose në klasë, nocionet nga ilustrimi (përfshirë veprimet/foljet dhe mbiemrat!) do të emërtohen dhe shënohen. Kjo ndodh me post-it-copëzat e vogla të letrave ose në tabelë rreth e rreth ilustrimit. Variantet: secili/a nxënës/e shkruan së pari individualisht se çka mund të emërtojë, në vazhdim shkëmbim. Për përdorim dhe thellim pason në vazhdim një de-tyrë me shkrim, p.sh. Përkrahja e ilustrimit mundësisht saktë / Sajone një tregim për ilustrimin / Zhvendosuni në pozicionin e një personi, i cili është në ilustrim dhe përkrahja e ilustrimit nga ajo perspektivë («Unë jam gruaja me xhemper të verdhë. Unë qëndroj në vend. Prapa meje janë ...»).

- **Fusha e fjalës nga tema e një situate të të shkruarit**

(Niveli i ulët - deri te niveli i lartë):

- Tek rastet e të shkruarit për një temë të caktuar («Nëse unë do të isha një bujk/bujkeshë», «Sistemi shtetëror i vendit tonë» etj.) e vlen që paraprakisht me klasën ose grupin të shënohen nocionet (emrat, foljet, mbiemrat) dhe shprehjet në mënyrë korrekte, të cilat janë me rëndësi dhe ndihmuese për tekstin përkatës. Përmes kësaj mbledhjeje të fjalëve dhe shprehjeve relevante, N do të lehtësohen në aspektin e përmbajtjes si dhe në drejtshkrim. Fushat e fjalës mund të përpunohen dhe në vazhdim të krahasohen edhe vetë, nga dy ose nga tre. – si formë prezantimi janë të përshtatshme edhe cluster dhe mind-map, krahaso nr. 8.

2. Të vihen në dispozicion mjetet e zgjeruara gjuhësore (fillimet e fjaltive, shprehje specifike të tekstit etj.)

kl. 2–9

20 min.



Nëse para rasteve të caktuara të të shkruarit ose detyrave, me nxënësit/et, mblidhen gojarisht dhe shënohen në fletore jo vetëm fjalë të veçanta, por edhe elemente të zgjeruara gjuhësore, atëherë kjo listë mund të japë një kontribut me shumë vlerë për zgjerimin e kompetencës së të shprehurit. Kjo procedurë është e njohur para së gjithash në mësimin gojor (p.sh. para një diskutimi mblidhen mjetet e të folurit). Por kjo e tregon veten edhe në raport me rastet e të shkruarit. Zgjedhja e elementeve gjuhësore varet nga rasti i të shkruarit, ashtu siç e tregojnë shembujt vijues:

- Para një shënimi mbi një përjetim (pushimet, shëtitja, aventura etj.): fillime të ndryshme fjalish të gjenden dhe të përfshihen në mënyrë që stereotipet si «dhe pastaj» të menjanohen:



Është mirë që para të të shkruarit të bëhet një ushtrim paraprak gojor për një shembull konkret. Për vetë rastin e të shkruarit N do të marrin detyrën që të përdorin së paku tri fillime fjalish nga lista.

- Para një përshkrimi - (ilustrimi ose natyre): ose të mblidhen vendet e caktuara (event. me parafjalët konkrete) («Para shtëpisë qëndron...», «Në sfond shoh...», «Mbi breg...», ose mundësi për të shprehur ndjenjat («Mua më pëlqen posaçërisht...», «Unë mendoj që është bukur, që...», «Unë nuk e kuptoj plotësisht, pse», «Unë mund ta paramendoj që artisti...» etj.
- Para një teksti, në të cilin p.sh. duhet të mendohet për përparësitë dhe disfavoret e jetës në emigrim: të mblidhen shprehjet për të theksuar mendimin personal, të përpunohet një spektër më i gjerë se sa «Unë mendoj...» pra të përdoren shprehjet si «Unë mendoj, që...», «Unë kam pasur përvojën, që...», «Sipas pikëpamjes sime», «Qëndrimi im është ...», «Unë jam i bindur, që...», «Unë dyshoj, mos...» etj. Edhe këtu është e këshillueshme, që së pari të provohen shembuj përmes një diskutimi gojor dhe pastaj të jepet detyra që tek të shkruarit të përdoren së paku tri shprehje nga lista.

15

Nxitje për punë në leksik II: puna me tekstet me zbrazësira, prova rezervë etj.

Qëllimi

Shih të dhënat te nr. 14. Në kundërshtim me punën e atjeshme dhe me fushat e fjalëve, tek nxitjet vijuese bëhet fjalë për format përcjellëse me paracaktime të forta.

1. Tekste me vende të zbrazëta/zbrazësira (tekste me zbrazësira)

kl. 1-9

15 min.



Materiali:
Tekst i parapërgatitur
me zbrazësira

Puna me tekste me zbrazësira është më shumë një formë tradicionale e reprodukimit pasiv, e cila përdoret edhe për kontrollin në të mësuar. Për qëllimin e zgjerimit aktiv të leksikut kjo punë kontribuon vetëm nëse fjalët përkatëse në mënyrë plotësuese ushtrohen në format orientuese të përdorimit të tyre.

Procedura:

M e përgatit si fletë pune një tekst në të cilin mungojnë mjaft fjalë të cilat duhet të futen. («Tina vjel në kopsht _____»; «Madridi është _____ i Spanjës»). Është i mundur edhe një ilustrim i cili duhet të mbishkruhet.

Tina vjel në kopsht _____.

Madridi është _____ Spanjës.

Nëna blen bukën te _____.

Unë _____ me qejf një gotë qumësht.

Në _____ luan një film interesant.

Mjeku _____ një recetë.

Për _____ udhëtojmë për në det.

Një kalorës bart _____.

Flamuri _____ zbavitshëm në erë.

pushime armatimin valon

pi kryeqytet Bukëpjekës

i shkruan mjedhëz kinema

- Variante më të thjeshta: Fjalët që duhet të futen në tekst janë të shënuara në fund të fletës dhe ato duhet të renditen saktësisht. Ky variant është i përshtatshëm për 1.) për 1./2. e klasës me fjali dhe fjalë të thjeshta dhe 2.) për tekste tematike, tek të cilat është fjala për leksik specifik (p.sh.

në një tekst faktik mbi punimin e tokës të futen fjalët e sakta ose tek një grafikë pjesët e trupit apo në një hartë të shkruhen lumenjtë). Parakusht është që lënda të jetë përpunuar më parë.

Thellim: N duhet në vazhdim t'i sajojnë fjalitë e veta, në të cilat gjejnë shprehje fjalët.

- Variante më të vështira: N duhet t'i gjejnë vetë fjalët. Edhe këtu parakusht është që lënda (dhe event. edhe nocionet korrekte të gjuhës standarde) të jetë përpunuar më parë. Nëse është e qartë se cilat nocione duhet të futen në tekst, atëherë ky variant është i përshtatshëm edhe si kontrollë në të mësuar (p.sh. tek nocionet për historinë e vendit). Në rastet e tjera mund të jenë të sakta zgjidhje të ndryshme dhe mund të diskutohen (shembull. «Dini _____ përmes kaçubave, ai frikësohej shumë». Zgjidhjet: shpejtonte, rrëshqiste, vraponte...).
- Variantet «vlershë/fjalët rimuese»: Për t'i sqaruar janë fjalët rimuese. Shembull për nivelin fillestar: «Në një shtëpi / jeton një ____»; sipas nivelit të ngritet.
- Një funksion special, interesant në aspektin e diagnozës gjuhësore, e plotësojnë tekstet me zbrazësira, nëse si zbrazësira i lë të hapura fenomene të rëndësishme gramatikore: «Toni i frikësohet qenit të ke__»; «Unë ia jap nën ____ një puthje»). Këtu mund të jepet paraprakisht në kllapa forma bazë e fjalës së kërkuar, e cila pastaj duhet të futet si formë korrekte.: «Antonio ishte në Itali. Ata (kaloj) _____ atje pushimet»). Rezultatet japin informacione shumë të vlefshme mbi kompetencat gramatikore të secilit/ës nxënës/e në gjuhën e parë.

2. Të punohet me provë zëvendësuese

Kl. 2–9

30 min.



Mateiali:
Detyra të parapërgatitura
(shiko djathtas)

Tek prova plotësuese duhet që fjalë të caktuara (shpesh përmes sinonimeve) të zëvendësohen. Me këtë ndodh një zgjerim aktiv i leksikut, ku të gjithë N vijnë në shprehje dhe fjalët në vazhdim përsëriten dhe thellohen.

Variantet (E zbatueshme nga niveli i ulët sipas vështirësisë dhe sasisë):

- M e jep një fletë, në të cilën në një tabelë më së larti qëndron një fjali si p.sh. «Sot po bie shumë borë» ose «Nëna ime pi shpesh ujë nga një gotë e kaltër» (për secilën fjalë ose pjesë të fjalisë një rubrikë të tabelës). Në rrjeshtat e tjerë të tabelës duhet të shkruajnë N fjali ose pjesë të fjalisë me fjalë të njëjta (ose të kundërta): «Dje binte shi i lehtë», «Motra jote nuk e gjerb kurrë çajin nga një shishe e kuqe» etj.
- M e jep një tekst të shkurtër (1/2 e faqes; distancë e gjerë mes rrjeshtave) me këtë detyrë vijuese: «Zëvendësoni të gjitha fjalët e nënshënuara (ose: të gjithë emrat, të gjitha foljet, të gjithë mbiemrat) përmes një fjale e cila afërsisht ka kuptim të njëjtë!»
- Sikurse më lart por me detyrë, të gjitha fjalët të zëvendësohen me fjalë të kundërta («Qeni i vockël» → «Macja e madhe»; «Burri vraponte nëpër pyll» → «Gruaja rrëshqiste mbi bar»). Zgjerim me plot humor (e mirë për punë me partner): të shkruhen «tekste të kundërta», d.m.th. një tregim të tërë (ose një lajm nga gazeta) të shkruhet në të kundërtën e asaj që është.
- Sikurse më lart por e orientuar gramatikalisht: «Zëvendësoni të gjithë emrat në njëjës përmes emrave në shumës; a përshtaten foljet!», «Zëvendësoni të gjitha format e kohës së tashme me kohën e shkuar!», «Zëvendësoni të gjithë mbiemrat përmes formave të shkallëve të mbiemrit (mirë → më mirë)» etj.
- Ushtrimi stilistik: M e jep një tekst (të shkruar vetë) ku ka plot përsëritje të fjalëve dhe gjëra të tjera jo të bukura (p.sh. secila fjali fillon me «dhe pastaj» ose vijnë në shprehje shumë fjalë të zakonshme si «shkoj» dhe «bëj». N e përmirësojnë tekstin në ekipe dyshe; në vazhdim do të krahasohen zgjidhjet.

- Një formë fort e zgjeruar e provës zëvendësuese është ritregimi klasik. Këtu N duhet që një tekst të dëgjuar 1–3 herë më parë (tregim, tekst tematik, episod, përrallë e shkurtër) ta ritregojnë me fjalët e veta. Kjo formë nuk është shumë atraktive shkaku i karakterit artificial por për zgjerimin e leksikut mund të jetë shumë e vlefshme. Variante motivuese komunikative: secili/a N e merr një tekst të shkurtër (p.sh. artikull gazete), e lexon atë 2x dhe pastaj e jep përmbajtjen përmes fjalëve të veta. Në vazhdim artikujt origjinal shënohen me numra dhe ngjiten në anën e djathtë në klasë. Ritregimet do të shënohen me shkronja (a, b, ...) dhe ngjiten në anën e majtë. N i lexojnë ritregimet dhe mundohen t'i renditin me tekstin origjinal. Ata marrin shënime për pyetjen, se çfarë mungon ose çfarë është dhënë në mënyrë joprecize. Në përfundim diskutim në grup.
- Krahazo këtu edhe 16.3: Tekste paralele/të shkruarit gjenerativ.

3. Nxitje të mëtejshme

Për zgjerimin e leksikut përmes formës së lojës kontribuojnë tregimet -ABC (p.sh: Alma bleu ca dardha e ftonj goxha (të) hidhura).

qytet	profesion	folje	kafshë	mbiemër	pika
Berat	bukëpjekës	bezdis	bretkosë	budalla	5
Londër	lokomotivist	loz	lepur	laraman	5
Tetovë	trajner	tollovis	-	i/e turbullt	4

- E njëjta vlen edhe për «Lojën-gjeografike» klasike ku lojtarët/et duhet të shënojnë p.sh. një qytet, një vend, një lumë etj. (Rregulla e lojës: të gjithë e marrin një tabelë me rubrikat pyetëse (qyteti, vendi etj.); dikush thotë me zë të ulët ABC, një fëmijë tjetër thërret «Stop!»; për shkronjën përkatëse duhet të kërkohen nocione). Tabela për këtë natyrisht mund të modifikohet: një emër, një folje, një mbiemër; një gjendje shpirtërore etj.

16

Nxitje lidhur me ndërtimin e tekstit dhe ndarjen e tij (krh. edhe nr. 9)

Qëllimi

Për t'i plotësuar strategjitë tek nr. 9 «Rrezja kohore» dhe «Skema hyrje/pjesa kryesore/përfundimi», në vijim i gjeni disa procedura, në të cilat aspektet «Ndërtimi dhe ndarja» do të fokusohen dhe ushtrohen posaçërisht. Ato duhet t'u ofrojnë nxënësve rastin që strategjitë e theksuara t'i provojnë në kontekste atraktive.

1. Puna me tekste të prera

kl. 2–6

20 min.



M e shpërndan një tekst (5–10 fjali, sipas moshës), i cili është i prerë në shirita (për një fjali një shirit). Këtu do të duhej të bëhet fjalë për një tekst me veprim të orientuar me rrjedhë të qartë. Detyra: renditni shiritat, ngjiteni tekstin bashkë në mënyrë të saktë. Detyra të mundshme plotësuese: zgjerone tekstin, duke shtuar shirita plotësues. Ose: shënoni me ngjyra, cilët shirita i takojnë më shumë hyrjes / pjesës kryesore / ose përfundimit.

2. Puna me tregime të ilustruara


kl. 2–9

30 min.



Materiali:
Tregime të ilustruara të prera copa-copa

N marrin (individualisht ose nga dy) një tregim të ilustruar të prerë (4–8 ilustrime). Ata duhet t'i renditin në mënyrë të saktë ilustrimet, t'i ngjiten dhe ta përshkruajnë tregimin. (1–2 fjali për ilustrim). Detyrë e mundshme plotësuese: të shkruhet një hyrje dhe një përfundim plotësues. Burimet për tregime të ilustruara: gazeta si «20 Minuten», pjesë komike, interneti, karta me tregime të ilustruara p.sh. nga botuesi Schubi Lernmedien, Schaffhausen (në shumë shkolla janë në dispozicion).



3. Tekste paralele të shkruarit gjenerativ

kl. 2–9

30 min.



Materiali:
Tekst parashtrues (shiko djathtas)

N marrin një model teksti (p.sh. një tregim të shkurtër ose një poezi). Në bazë të këtij modeli ata shkruajnë një variant. Do të ndryshojnë p.sh. personazhet (në vend të një qeni që leh, del një mace e cila mjaullin). Një fushë e mirë për përdorim janë edhe letrat, letrat me kërkesë për falje ose kërkesat, të cilat do të ndryshojnë prej modelit. Puna me tekste paralele është veçanërisht e përshtatshme për N të dobët, ngase këtu kërkesat janë të vogla për krijimtari personale gjuhësore. Shiko gjithashtu edhe më lart te 15.2: Prova zëvendësuese. Krah. për të shkruarit gjenerativ kontributin e mirë nga M. Lüth nën http://www.kompetenzzentrum-sprachfoerderung.de/fileadmin/user_upload/didacta-Version.pdf.



4. Të analizohet ndarja e teksteve

kl. 4-9

30 min.



Materiale:
Tekste (shih djathtas)

Varianti 1: N marrin një ose disa tekste (tekste me rrjedhë të qartë kronologjike!) si dhe një fletë, në të cilën e vizatojnë një rreze kohore (krah. nr. 9). Pastaj ata duhet që stacionet veç e veç të tekstit t'i shënojnë në mënyrë të përmbledhur në rreze kohore.

Varianti 2: N marrin tekste me kërkesa të larta të llojeve të ndryshme dhe duhet që t'i shënojnë me ngjyra të ndryshme së paku tri pjesët hyrjen / pjesën kryesore / përfundimin, përmbledhjen.

5. Për një fillim të gjendet një fund dhe anasjelltas; «Tregimet-Sandwich»

kl. 2-9

30 min.



Materiale:
Fletë me fillime tekstesh

Nxënësit e marrin fillimin e një teksti (p.sh. fillimin e një tregimi ose hyrjen e një artikulli nga gazeta). Individualisht ose në grupe dyshe ose treshe duhet të shkruajnë tekstin deri në fund dhe gjithashtu gjatë kësaj pune të shënohen edhe pjesët si pjesa kryesore dhe përfundimi/përmbledhja. Tek tekstet e gjata duhet të vënë mestituj. Në vazhdim ata e paraqesin tekstin e tyre para të tjerëve. Kjo është interesante sepse të gjithë e kanë të njëjtin fillim dhe tekstet dalin megjithatë krejt të ndryshme.

Varianti 1: N e marrin fundin e një teksti dhe duhet të shkruajnë fillimin dhe pjesën kryesore.

Varianti 2: «Tregimet Sandwich»: N marrin fillimin dhe fundin e një teksti (tregim, shaka, tekst tematik) dhe duhet të sajojnë pjesën e mesme.

6. Rregullat e lojës, udhëzimet për punë dore, recetat të shkruhen dhe të mblidhen

kl. 2-9

40 min.



Përpilimi i teksteve me veprime orientuese si rregullat e lojës, udhëzimet për punë dore, recetat etj. kërkon një ndërtim veçanërisht të qartë, sepse në të kundërtën udhëzimet janë vështirë të kuptueshme ose s'kuptohen fare. Kualiteti i një teksti të tillë lejon që të matet menjëherë se sa mirë ai «funksionon». Të vendosen me klasën mbledhja e recetave, udhëzimeve për punë dore etj. është njëkohësisht një projekt atraktiv, sepse këto tekste janë për përdorim të drejtpërdrejtë praktik. Atraktive janë edhe përmbledhjet dygjuhësore në bashkëpunim me mësimdhënësit e mësimi të rregullt, shih më poshtë nr. 21.

Qëllimi

Aspektet e ushtrimit të stilit gjenden në mënyrë të nënkuptuar tek një mori e situatave të të shkruarit. Nxitjet vijuese ofrojnë situata për një ushtrim të drejtpërdrejtë të varianteve gjuhësore dhe stilistike nga anët e fjalisë, tekstit, llojit të tekstit. Qëllimi i tij është sensibilizimi i nxënësve/eve për aspektet stilistike dhe mundësitë në gjuhën e parë.

1. Puna me provë të zgjeruar dhe të lënit jashtë

kl. 2–9

30 min.



Materiali:

Kartela të parapërgatitura për provën e të lënit jashtë (fjali e gjatë me 8–10 fjalë). Kartela të zbrazëta ose shirita për fjali personale.

Tek prova e zgjeruar bëhet fjalë për t'a zgjeruar një fjali me elemente plotësuese (mbiemra, pjesë të fjalisë, fjali plotësuese) («Gruaja këndon» → «Gruaja e re e veshur mirë, e cila u arsimua në Romë si këngëtare, këndon në sallën koncertale të zbukuruar me plot luks, këngë të mrekullueshme». Tek prova për të lënë jashtë duhet të ndodhë e kundërta, të fshihen të gjitha elementet, deri sa të mbetet vetëm bërthama e fjalisë: «Një qen i murmë me qime të ashpra, i cili i kishte i kur pronarit të tij, e hante një koc të madh» → «Një qen hante»

Një	qen	i murmë	me	qime	të ashpra,	i cili	i	kishte
ikur	pronarit	të tij,	e	hante	një	koc	të madh	

Një	qen	i murmë	hante	një	koc	të madh
-----	-----	---------	-------	-----	-----	---------

Një	qen	hante
-----	-----	-------

Tek puna me provë të zgjeruar dhe të lënit jashtë, nxënësit zhvillojnë përmes lojës ndjenjën e tyre për mundësitë gjuhësore dhe stilistike në fushën e fjalisë.

Variantet:

- M i ushtron së pari një ose dy shembuj me klasën/grupin. Në vazhdim secili N (ose nga 2 N) e merr nga një fjali dhe disa shirita letre, në të cilën ai/ajo duhet të shkruajë mundësisht një version të gjatë. (Prova e zgjeruar)
- M e jep një fjali të shkurtër në klasë, p.sh. «Qeni leh.» Secili/a N duhet që këtë fjali ta zgjerojë me një element (mbiemër, gjymtyrë të fjalisë, pjesë e fjalisë): «Qeni i uritur leh», «Qeni i uritur leh tërë ditën», «Qeni i uritur leh tërë ditën sepse ai ka uri» etj. Së pari të ushtrohet me gojë pastaj me shkrim.
- Për provën e të lënit jashtë mund të zgjidhen tekste nga tregimet etj. nga të cilat heqen të gjitha ato pjesë që nuk janë të patjetër të domosdoshme.
- Prova me zgjerim mund të zgjerohet nga një tekst i plotë, i cili përbëhet nga shumë fjali të shkurtëra. Detyra: Teksti të zgjerohet së paku në madhësinë e dyfishtë.

2. Ushtrime me lidhje dhe zgjidhje të fjalive

kl. 3–9

30 min.



Materiali:
Fletë të parapërgatitura
me fjali të shkurtëra
(shih djathtas)

Ushtrimet me lidhje dhe zgjidhje të fjalive përkrahin kompetencën sintakso-re dhe stilistike të N dhe e zgjerojnë repertoarin e tyre. Për një thellim më të mirë duhet të ushtrohen shumë herë. Me rëndësi: nocionet «zgjedhimi/lidhëza» ose «fjalja e nënrenditur» nuk duhet të mësohen; këtu është fjala për përdorim praktik.

Variantet:

M e jep një fletë me disa fjali partnere pak të shkurtëra. Shembull: «Unë kam uri. Unë dëshiroj të ha»; «Unë jam i lodhur. Unë nuk kam fjetur gjatë.»; «Ai më ka premtuar. Ai shkon me mua në kinema.»; «Unë jam i shqetësuar. A e ke kuptuar vërtet?»; «Duhet për të qenë i shpejtë. Mund të fitohet në garë.»; «Ishte vonë. Ne arritëm në atdhe.». Pas një bisede të parë do të shënohen me klasën lidhëzat (fjalët lidhëse) të mundshme, me anën e të cilave mund të lidhen fjalitë partnere: Dhe, ngase/sepse, që, nëse, më mirë, me këtë, përpara, gjatë, që, nëse, edhe pse, por etj. N i lidhin fjalitë partnere me një lidhëz të përshtatshme dhe i shkruajnë ato. Thellimi: Me lidhëzat nga lista e bërë të sajohen vetë fjali, lidhëzat të nënvizohen me ngjyrë të kuqe. Ose: të bëhen në mënyrë të dyanshme fjali partnere, të cilat duhet të lidhen mes vete.

Fjalitë të zgjidhen: këtu N marrin fjali të gjata të lidhura mes vete, të cilat duhet t'i ndajnë në dy pjesë të fjalisë: «Unë nuk mundja të gëlltitja asnjë kafshatë, sepse nuk mund të duroja spanaqin» → «Unë nuk mund të gëlltitja asnjë kafshatë. Unë nuk e duroj spanaqin».

3. Ushtrime integruese të stilit me shirita letre

kl. 3–6

30 min.



Materiali:
Për N 3–4 shirita letre.

Forma ushtruese vijuese bashkon aspekte të ndryshme dhe dallohet nga karakteri i vet aktiv orientues-veprues si mësim intensiv i shkëlqyeshëm.

Procedura:

a) M e ngjet një ilustrim. Secili/a N i merr 3–4 shirita letre (fletë A3 të prera drejt në 4–5 shirita) dhe në secilin shirit e shkruan një fjali për ilustrimin.

b) Të gjithë shiritat do të mblidhen dhe do të përzihen mirë. Pastaj N formojnë grupe treshe. Secili grup merr 9–12 shirita. Me ta duhet të përmbledhin një tekst për ilustrimin. Në mënyrë plotësuese duhet të bëjnë punë intensive në stil: shiritat e «dyfishtë» të priten, të zëvendësohen fjalët e përsëritura/ fillimet identike të fjalive, eventualisht disa fjali të mblidhen bashkë, të kihet kujdes në ndërtim etj. Nëse është e nevojshme N mund të marrin shirita të tjerë të zbrazët dhe të plotësojnë fjalitë, në mënyrë që teksti i tyre të jetë i ndërtuar mirë.

c) Shiritat do të ngjiten në renditjen përkatëse definitive. Grupet i prezantojnë tekstet e tyre dhe i komentojnë tekstet në mënyrë të ndërsjellë.

4. Eksperimente me lartësi stili dhe lloje të tekstit

kl. 5–9

30 min.



Materiali:
Sipas variantit
(shih djathtas)

Ushtrime atraktive dhe edhe argëtuese stilistike janë të mundura në forma të ndryshme në fushën e teksteve të plota. Është për të vënë re se këto eksperimente kanë si parakusht që duhet pasur pak ndjenjë për gjuhën e parë dhe shumëllojshmërinë e saj specifike. Aty ku mungon kjo ndjenjë duhet të ndërtohet dhe zgjerohet përmes udhëzimeve përkatëse dhe informacioneve. E njëjta gjë vlen edhe për njohuritë për tekstet e ndryshme (poezi, tekst informativ, përrallë, sms, komik etj.).

Lartësia e stilit, variantet:

- Variacionet e një teksti (të shkurtër) të përshtatshëm në lartësi të ndryshme të stilit. Detyra të mundshme: «Ju keni marrë një libër nga shoku ose shoqja juaj nga vendi i prejardhjes, ose nga gjyshërit apo nga ambasada e vendit tuaj të prejardhjes. Shkruani për secilin nga këta persona një letër falënderuese, e cila i përgjigjet nga ana e stilit!» (Variacione nga pak deri shumë mënyrë formale, event. nga dialekti deri te gjuha standarde).

- Zgjedhni pesë tabela komunikacioni (p.sh. tabela -stop, rrugë njëkahëshe, ndalohet lakimi etj.). Shkruani se çfarë duan të thonë këto tabela (p.sh. «Këtu duhet të ndalemi», «Këtu mund të shkosh vetëm në një ndrejtim» etj.) Formuloni këtë informacion me mënyra të ndryshme politese! Mund të përdorni edhe dialektin dhe shprehjet e rrugës (Tabela stop: «A do të ishit aq i sjellshëm që të ndaloni këtu? Faleminderit!» deri «Budalla, frenoje kerrin tënd!»). Krijoni një pllakat argëtues për këtë (A3 ose A2).
- Merrni një artikull të shkurtër nga gazetatat, një poezi ose një tekst tjetër të shkurtër. Merruni vesh në grup tresh ose katërsh, kush e riformulon atë dhe në çfarë stili (p.sh. në dialekt, shprehje rruge, gjuhë-komike, gjuhë të përzgjedhur, me gjuhë «deri në tepri të përzgjedhur»). Shkruani variantet tuaja dhe lexojani njëri-tjetrit!

Format e tekstit, variantet:

- Merrni një tekst të shkurtër, p.sh. një artikull nga gazetatat. Mendoni si klasë e tërë ose në grupe nivelesh, format e ndryshme të tekstit në të cilin mund të shndërrohet teksti (poezi, tekst tematik, përrallë, telegram, sms, komik, lojë dëgjimore, lajmërim senzacional etj.). Merruni vesh kush në çfarë forme do të shkruajë tekstin (individualisht ose në grup dysh). Në fund krahasoni dhe diskutoni format e ndryshme të tekstit!
- Përpikuni të bëni të njëjtën gjë me temat, të cilat janë të lidhura me vendin tuaj të prejardhjes! Shndërroni p.sh. skenat nga jeta e një personaliteti të rëndësishëm në një lojë dëgjimore ose bëni një poezi për një pamje të një vendi ose sajoni telegrame ose shënime gazetareske për ngjarjet historike!
- Grumbulloni shembuj tekstesh për format e ndryshme të tekstit, bëni një ekspozitë. Secili/a duhet të prezantojë një shembull (nga poezia e deri te pjesa komike, nga libri tematik e deri te e-mail ose sms) dhe t'u sqarojë të tjerëve se çfarë është speciale në gjuhën e këtij shembulli.

Kontribute të rëndësishme për ushtrimin e stilit ofrojnë edhe këto nxitje vijuese:

- Tek nr. 4 ku janë të përshkruara format e tregimeve skelë, tregimet me fjalë nxitëse, struktura e tregimit, natyrisht mund të përdoren (si edhe nxitje të tjera të ndryshme) shumë mirë gjithashtu edhe për qëllimet e ushtrimit të stilit në fushën leksikore.
- Nxitjet te 15.2 për punën me provë plotësuese japin një kontribut të mirë për ushtrimin e stilit në fushën leksikore.
- Tek nr.16.3 te puna e përshkruar me tekste paralele (të shkruarit gjeneral) është me shumë vlerë në aspektin stilistik: orientimi në një model të paradhënë dhe marrja e elementeve nga i njëjti ka një efekt lehtësues dhe ushtrues të stilit.
- Të preferuara dhe të dobishme për ushtrimin e stilit janë edhe të ashtuquajturat «orët e të shkruarit gojor»: Nuk e shkruajnë vetë një tekst, por diskutohet gjerësisht se si mund të ndërtohet një tekst për një temë të caktuar. Variacione: Do të diskutohet për një tekst të një nxënësi që veç është i shkruar (i cili eventualisht është shkruar para një kohe ose është nga një klasë tjetër).

Nxitje për punë në stil II: të shkruhet saktë/të paraqitet bukur/ interesant dhe të përmbledhet

Qëllimi

Edhe në gjuhën e tyre të parë nxënësit/et duhet të kenë rastin të zhvillojnë një repertor të gjerë stilistik. Në këtë fushë hyjnë pjesë të shkathtësive si «të mund të shkruhet saktësisht», «të mund të tregohet bukur» etj. Pa ushtrime të përshtatshme, kategoritë si «saktësisht», «paraqitje e bukur», «interesante» mbeten fjalë abstrakte, me të cilat nxënësit/et nuk mund të fillojnë asgjë. Qëllimi i nxitjeve vijuese është që këto kategori të bëhen të përjetueshme dhe përmes ushtrimeve të përshtatshme dhe situatave të të shkruarit të lihen që të provohen.

1. Të përshkruhet saktësisht: variantet

kl. 2–9

20 min.



Materiali:
Kupon i kasës,
Të tjera sipas variantit
(shih djathtas)

- Secili/a N e sjell një kupon (Migros, Coop, Aldi etj.) dhe e ngjet në mes të një flete A3. Rreth e rreth ai/ajo shkruan mundësisht në mënyrë sa më të saktë se për çfarë përdoren secila prej sendeve veç e veç. Sqarimet dhe sendet në fletën e pagesës së kasës lidhen me shigjeta. (Ideja nga «Sprachfenster», Themenheft Schreiben, f. 29).

Nëna ime ka nevojë për miell, në mënyrë që të gatuj torten për ditëlindjen e vëllait. Me pjesën e mbetur të miellit ajo bën brum për picë, të cilën pastaj fëmijët mund ta mbushin me mëlmesat që i duan.

Einkaufsliste	L. Nr.
Hackfleisch 500g	5.20
Mandeln gemahlen	5.40
Kopfsalat Bio	2.10
Salz	0.05
Mehl	1.80
Taschentücher	5.20
Freilandeiern	3.60
Toastbrot	2.80
Gummihandschuhe	3.80
Sparschäler	5.60
Deo Stick	3.85
Schwamm 3er Pack	2.45
Reibkäse	3.80
Summe	53.95
Bar	60.-
Rückgeld	6.05
Besten Dank für Ihren Einkauf	

Vezët mund të përgatiten në mënyra të ndryshme. Mund të hahen pasi të jenë zier mirë, ose të fërguara, mund të fërgohen vezë në sy ose edhe si vezë të trazuara janë shumë të shijshme.

«Qëruesi kursimtar» quhet kështu ngase kur qërojmë me te p.sh. patate ose karota, mbeten shumë pak mbeturina.

- Secili/a N e merr nga mësimdhënësi një objekt (p.sh. një pecetë ose një kapak). Ai/ajo duhet ta përshkruaj sa më saktë, por pa e thënë emrin e objektit. (Në vend të kësaj flitet për «XY tim»). Në përfundim objektet do të vendosen majtas në klasë dhe tekstet djathtas. Tekstet janë të shënuara me numra, objektet me shkronja. N mundohen të gjejnë, cili tekst për cilin objekt është i përshtatshëm (p.sh. 3 = F). Krahazo edhe më lart nr. 7.2b.
- Variacionet për 2: përshkrimi i ilustrimeve (kartave postare etj.) / të kafshëve të ndryshme (kafshë shtofi, ilustrime) / skenari «shpallja unë shes» ose «shpallja e sendeve të gjetura».
- M ose një N e bën një veprim të vogël 2–3 herë (p.sh. e merr një libër nga dollapi). N mundohen që të përshkruajnë veprimin në të gjitha detajet. Në vazhdim ata i krahasojnë dhe diskutojnë tekstet e tyre. Variacioni (më i vështirë): dy N e luajnë një skenë të vogël (përshëndetja etj.); këtë skenë ta përshkruajnë në të gjitha detajet.
- Të paramendojmë, ne do të duhej t'i sqaronim stërgjyshes sonë, si bëhet një thirrje me telefon të dorës ose si aktivizohet një kompjuter ose si lidhet në internet! Përpjekja; në vazhdim të kontrollohet saktësia e teksteve.

2. Të tregohet bukur e me gjallëri: variantet

kl. 2–9

20 min.



- M ua paraqet N këtë «recetë» vijuese për të shkruar bukur e me gjallëri: dil në rolin e personit/ave të tregimit! Mbylli sytë dhe mendohu se çka ndiejnë, mendojnë, frikësohen, shpresojnëPërshkruaje krejt këtë pastaj në tekstin tënd!» Në vazhdim receta do të luhet së pari gojarisht, pastaj me shkrim tek temat e përshtatshme. Shembuj: «Një diskutim në tavolinën e drekës», «Një përjetim në atdheun e prindërve të mi», «Çfarë tregon gjyshja ime nga koha e rinisë së saj».
- Një recetë tjetër e cila do të mund të luhet sipas modelit të lartpërmendur: «Mbylli sytë para se të shkruash. Mendohu për tregimin tënd dhe paramendoje se ai po zhvillohet si një film në kokën tënde. Shkruaje tash sa më gjallërisht dhe në detaje që është e mundur!»
- Një këshillë që të çon tek një paraqitje më e bukur: «Përdore të folurit e drejtpërdrejtë, lini njerëzit të flasnin mes vete!» Edhe kjo duhet që së pari të luhet dhe të provohet me gojë e pastaj me shkrim.
- Tekstet bëhen më të gjalla nganjëherë nëse ato krijohen si përjetime personale (në vend të personit të tretë). Nëse merren pastaj këshillat e përmendura më lart, sigurisht nuk do të mungonte suksesi.
- Situata të mira për provimin e stilit të të shprehurit bukur e me gjallëri ofrojnë edhe tregimet e ilustruara. N janë të liruar këtu nga detyra për të sajuar një veprim të tyre personal, ata mund të përqendrohen për të krijuar tekstin e tyre në mënyrë tërheqëse. Me rëndësi është që pas shkrimit, tekstet e ndryshme të krahasohen dhe të komentohen.
- Edhe ritregimet dhe tregimet e ilustruara ofrojnë mundësi të vlefshme, për të provuar një stil të gjallë e të bukur paraqitës, shiko për këtë më poshtë (18.3 dhe 21).

3. Të ritregohet saktësisht dhe të përmbledhet; variantet

kl. 3–9

30 min.



Materiali:
Tregimi si parashttrim për ritregim
(shih djathtas)

Ritregimet shfaqen në shkollë dhe në jetën e përditshme në format më të ndryshme: Nga raporti për një film televiziv ose një ëndërr e deri te shënimi telefonik i përmbledhur, nga parafrasa e lirë e deri te një rithënie e saktë deri në detaje e një teksti të pranishëm ku do të duhej të riprodhoheshin edhe elementet stilistike. Me përparësi me vështirimin tek ushtrimi i stilit është se N tek ritregimi janë të liruar nga ajo që të sajojnë një veprim (sepse ky veç është i paradhënë) dhe kështu mund të koncentrohen plotësisht në aspekte gjuhësore. Shembuj dhe mundësi:

- Ushtrim paraprak: diskutim se ku dhe përse kemi nevojë për ritregime dhe përmbledhje në shkollë dhe në jetë. N duhet të jenë të vetëdijshëm sa sa janë të rëndësishme këto lloje të teksteve në përditshmëri (edhe nëse p.sh. është fjala për skeçe ose thashetheme!). Në vazhdim mbledhja e «ritregimeve» të përditshmërisë gjuhësore dhe e «përmbledhjeve» nga jeta e N e disa ditëve të fundit (kush kujt çfarë i ka treguar?)
- M e lexon një tregim të shkurtër ose të gjatë 2–3 herë. N e tregojnë rrëfimin mundësisht sa më saktë, por guxojnë t'i fshehin 1–2 gabime. Në vazhdim lexim i dyanshëm: Zbuloni gabimet? (Krah. nr. 7.4)
- Ritregim me ndërrim të perspektivës: N lexojnë një tregim (p.sh. një përrallë, një legjendë ose një episod nga literatura personale). Në vend se ta tregojnë pastaj rrëfimin, zhvendosen në një figurë të caktuar dhe e tregojnë rrëfimin nga ajo perspektivë (shembull nga bota e përrallave gjermane: «Kësulëkuqja» të tregohet nga perspektiva e ujkut).
- Tregimi i njëjtë të ritregohet në lloje të ndryshme tekstesh: krah. këtu 17.4.
- Rreth ritregimeve dhe përmbledhjeve në një formë shumë të shkurtër bëhet fjalë edhe te shënimet telefonike, të cilat nganjëherë duhet bërë për prindërit. Kjo mund të ushtrohet përmes lojës (M dhe një N zhvillojnë një bisedë fiktive telefonike me lloj-lloj detyrash, N tjerë marrin shënime në një copë letre).

- Si një nënloj të veçantë të ritregimeve lënë për t'i kuptuar përmbledhjet dhe shënimet, ashtu si edhe N duhet t'i bëjnë në rast të provimeve etj. Diskutim/shkëmbim për këtë, në vazhdim provë konkrete. Këtu N p.sh. mund t'i përmbledhin pikat më të rëndësishme të leksionit të fundit dhe pastaj t'i diskutojnë listat e tyre në mënyrë kritike. Varianti: M e mban një referat ose e tregon një film mësimor, në vazhdim N duhet t'i përmbledhin gjërat më të rëndësishme në 5–10 pika.

4. Të tregohet në mënyrë interesante: variantet

kl. 4–9

35 min.



Materiali:
Event. tregime me ilustrime ose fletë me tema/tituj (shih djathtas)

- Përgatitje gojore: Bisedë rreth kategorive «mënyrë interesante» dhe «mënyrë monotone». Çfarë kuptimi kanë këto kategori? Çfarë do të thotë kjo për të shkruarit tonë personal? Thellim: M ua lexon N një tekst (të shkurtër) interesant dhe një tekst monotone ose u jep atyre tekste të tilla. Përse njëri është interesant, tjetri monotone? Eksperimenti: Si mund ta bëjmë tekstin monotone interesant? Përpjekje; zgjidhjet të krahasohen.
- N marrin «recetat» vijuese për të shkruarit interesant (si kopje):
 - Filloje tekstin tënd me një fjali, e cila i bën lexuesit/et kureshtarë (p.sh. «Në këtë ditë gjithçka shkoi mbrapsht», «Gjithnjë e më afër më afrohej qeni i tmerrshëm.»).
 - Mos tradhëto gjithçka menjëherë. Jepu lexuesve/eve së pari udhëzime, të cilat i bëjnë ata kureshtarë! («Çfarë përjetova sot sigurisht që nuk do ta harroj aq shpejt. Ka të bëjë me një kafshë më shumë se sa të rrezikshme.»)
 - Përshkruaj ndjenjat, frikën dhe shpresën e personave në tekstin tënd! («Ai dridhej dhe mendonte: «A ka vallë shpëtim për mua?»»)
 - Ndërpreje tekstin tënd me pyetjet, drejtohu direkt lexuesve/eve. (P.sh. Çfarë do të kishit bërë ju në këtë situatë të ndërlikuar?)
 - Formuloje kulminacionin ose zgjidhjen e mënyrës interesante tek para përfundimit të tekstit.
 - Mendoje për tekstin një titull, i cili lexuesit/et i bën kureshtarë («Tragjedi në Turqi», ose «A do të më hajë tigri mua?»).

Pastaj N marrin një ose disa modele përmes të cilave ata në bazë të këtyre «recetave» do të duhej të shkruajnë një tregim interesant. Shembull: Një tregim i përshtatshëm me ilustrime; një temë si «Një përjetim i frikshëm» ose «Këtu unë kisha vërtet frikë».

Pasi të shkruhen tekstet do të krahasohen dhe do të diskutohet si dhe sa mirë janë zbatuar «recetat» veç e veç.

- Mbledhja (bashkë me nxënësit/et) e temave interesante, titujve dhe/ose fillimit të teksteve (1–3 fjali). N shkruajnë në shkollë ose si detyrë tekste për këtë. Këto mund të mblidhen dhe të lidhen bashkë në një libër («Tregimet tona të frikshme», «Storiet interesante» etj.).

Qëllimi

Në kuadër të të shkruarit të teksteve rezultojnë shumë situata autentike mësimi dhe reflektimi edhe për temat gramatikore (sintaksë, morfologji). Udhëzimet vijuese ilustronë se si krijohen situata të tilla mësimore dhe si mund të shfrytëzohen ato. Nuk do të trajtohen ortografia, ngase rregullat e drejtshkrimit janë të ndryshme për secilën gjuhë të prejdardhjes.

1. Sintaksa

kl. 2–9

20 min.



Materiali:

Kartela me fjali të prera copa-copa (shih djathtas)
event. top-letre higjenike.

Kontribute të rëndësishme për zhvillimin dhe shkollimin e ndjenjës për fjalinë dhe shumëllojshmërinë sintaksore japin ushtrimet dhe eksperimentet e dhëna tek nr. 17 (Nxitje për stilin). Në mënyrë të veçantë për nxënësit/et e rinj/e reja (klasa 1–2), janë të përshtatshme ushtrimet vijuese për ndërtimin zbulues, veprues të ndjenjës për fjalinë (Materialin për këtë e parapërgatitin M ose N e vjetër):

- M shkruan fjali të thjeshta në shirita letre dhe i pren pastaj këto jo në fjalë por në pjesë të fjalisë. Kartelat që i takojnë një përkatësie mbahen me një kapse byroje. N marrin (vetë ose në grup dysh) një ose disa grupe kartelash dhe duhet që këto t'i vendosin bashkërisht në fjali funksionale (dhe ev. t'i kopjojnë).

Shembull:



Nganjëherë janë të mundshme edhe disa zgjidhje, për këto duhet patjetër të diskutohen (ndjenja për gjuhën!).



- N marrin (vetëm ose në grup dysh) tri lista: 1.) Me 10–12 emra (kryefjalë), 2) me 10–12 folje, 3.) me 10–12 kundrinor të drejtë dhe/ose përcaktor vendi apo kohe.


qeni nëna burri njerëzit topi fëmija zhongleri lopët nxënësit huti	fluturon ujit kullot zien shkruan leh nget luan punon gjuan
në fletore natën në luadh mbi njerërotësh tërë ditën makarona vazot e luleve në fabrikë në dhomë në derën e oborrit	



Edhe për «kompjuterin e fjalive» nga topi i letrës higjenike (faqja tjetër) prehet një letër A4 siç është e paraqitur këtu.



N i zhvendosin tri listat njëri kundër tjetrës dhe i shkruajnë të gjitha fjalitë që kanë kuptim. Variante: Listat vendosen njëra pranë tjetrës rreth e rreth një topi letre higjienike të zbrazët dhe forcohen me shirita ngjithës. Përmes asaj që shiritat shtyhen njëri kundër tjetrit, mund të gjenerohen me këtë «kompjuter fjalish» fjali me kuptim dhe pa kuptim.



- Për N e vjetër ushtrimet e përshkruara më lart lejojnë të zgjerohen përmes asaj që pjesë plotësuese të fjalisë (kundrinë e zhdrejtë; përcaktor vendi ose kohe, event. edhe të tjera) përfshihen gjithashtu.

2. Morfologjia (format korrekte)

kl. 3–9

25 min.



Materiali:
Teksti si paracaktim

Puna e përshkruar tek 15.2 me provat plotësuese mundëson të përdoret shumë mirë për ushtrime gramatikore përmes dhënies së detyrave të përshtatshme (kl. 3–6).

Shembuj:

- N e marrin një tekst (punë në grup dysh). Ata duhet atë ta kopjojnë në atë mënyrë që të gjithë emrat të shkruhen në shumës. Pyetja dhe diskutimi: çfarë sjell kjo në aspektin gramatikor? (Përgjigje: edhe foljet dhe mbiemrat duhet të përshtaten!)
- Variantet: të gjitha format e shumësit të zëvendësohen me njëjës; të gjitha foljet në kohën e tashme të zëvendësohen me foljet në kohën e pakryer ose të kryer (ose e kundërta); të gjithë mbiemrat e shkallës pozitive të zëvendësohen me shkallën krahasore ose sipërore.
- Për një funksion special dhe interesant në aspektin e diagnozës gjuhësore i referohemi në 15.1 (Zbrazëtitë për fenomene të caktuara gramatikore si mbaresat etj. të lihen të lira; të kuptohen gabimet si udhëzime për pasiguritë përkatëse dhe nevojat për ushtrime).
- Ushtrimi i fenomeneve të caktuara gramatikore mundëson shpesh lidhjen e mirë me fushën e të shkruarit, nëse detyra me shkrim formulohet në mënyrë përkatëse. Shembuj:
 - Fusha e ushtrimeve për format e së shkruarës: detyrë, të shkruhet një tregim nga e kaluara (Temat si: Çfarë bëja unë si 3-vjeçar/e; një përallë: Diçka nga historia ...)
 - Qëllimi i ushtrimit, mbiemrat: detyra, të përmbledhet mundësisht një përshkrim i hollësishëm i ushqimit të preferuar personal; mundësisht paraqitje e bukur ilustruese etj.
 - Qëllimi i ushtrimit lidhëria: temat si «Nëse do të isha unë një magjistar/e», «Sikur të mos kishte më shkollë», «Nëse (gjyshërit-)prindërit e mi nuk do të kishin emigruar».

**Ide për kontekste të
caktuara të të shkruarit**

Situata të të shkruarit, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Qëllimi

Shumë nga idetë e shfletuara deri më tash mundësojnë që pa problem të merren në mësimin e gjuhës së prejardhjes. Situatat vijuese të të shkruarit japin nxitje të tjera për këtë. Ato qëndrojnë në lidhje të ngushtë tematike qoftë me vendin e prejardhjes ose për jetën në dhe mes dy kulturave dhe gjuhëve, ashtu si edhe është karakteristike për nxënësit/et e mësimin në gjuhën e prejardhjes.

1. Tekste me gjëgjëza

kl. 4–9

30 min.



N marrin për detyrë për të përshkruar diçka nga historia, kultura ose gjeografia e vendit të prejardhjes, pa e përmendur emrin e ngjarjes përkatëse, gjegjësisht personalitetit përkatës ose të qytetit. Tema do të duhej të kufizohet në kuadër të historisë, kulturës, gjeografisë ose të personaliteteve. Ushtrimi mund të bëhet së pari me gojë, në vazhdim duhet që gjëgjëzat të formulohen me shkrim, të mblidhen dhe të shkëmbehen.

2. Reportazhet, pllakatet, referatet

kl. 3–9



Tek ky projekt i madh mësimor N krijojnë një reportazh, një pllakat ose një referat për një vend, një ngjarje ose personalitet nga vendi i prejardhjes. Forma e krijimit do të diskutohet me N (p.sh. pllakat ose referat me fletën përkatëse të punës). Kërkesat natyrisht do të caktohen sipas moshës. Për projektin (përfshirë prezentimin) duhet të llogariten dy ose më shumë orë dyshe. Është e arsyeshme që të bëhet e ditur para pushimeve të gjata, ashtu që N gjatë pushimeve të mund të mbledhin material dhe të përgatiten.

3. Fletët e punës, tekste tematike, kuiz etj.

kl. 4–9

45 min.



Në vend që M për mësimin në gjuhën e prejardhjes të bëjë gati fletët e punës, tekstet tematike, fotografitë, prezentimet përmes kompjuterit etj. këtë mund ta bëjnë nganjëherë edhe nxënësit/et shumë mirë. Me këtë rast ata edhe mësojnë gogja dhe e përsëritin përmbajtjen. Me rëndësi është që paraprakisht të merren vesh, se çfarë duhet të krijohet (p.sh. një fletë pune ose një kuiz me rastin e përfundimit të një teme).

4. Intervistat, intervistat fiktive

kl. 5–9



N marrin për detyrë për të zhvilluar intervista për një temë të caktuar bashkërisht që më parë, këtë t'a dokumentojnë me shkrim dhe t'ia prezantojnë klasës. Tema të mundshme dhe partnerët/et intervistues/e: Kujtimet e prindërve ose gjyshërve tanë për fëmijërinë e tyre në vendin e prejardhjes / Intervistë me dikë që është moshatar në vendin e prejardhjes për temën koha e lirë dhe perspektivat për të ardhmen / Intervistë me njerëzit në vendin në të cilin N jetojnë, për temat si racizmi, të huajt, integrimi. Me rëndësi: paraprakisht duhet të diskutohet me N se si bëhet një intervistë: të shënohen pyetjet kryesore, pyetjet e hapura të formulohen (jo pyetje po/jo, por më shumë impulse: «Tregoni ju lutem pak, ...», intervistuesi/ja vetë të flas pak. Edhe forma e dokumentimit me shkrim duhet të sqarohet: Jo të shkruhet gjithçka fjalë për fjalë, por të përmbledhet. Një mjet për inçizim: magnetofon ose telefoni i dorës.

Variant nxitës: të sajohen dhe të shënohen intervista fiktive me personalitete të mëdha nga kultura ose politika kombëtare.

5. Kërkesa, thirrje

kl. 5–9

45 min.



Në vazhdim të diskutimeve të gjendjeve të pakënaqshme ose të ngjarjeve në vendin e prejardhjes ose në vendin e tanishëm, do të mendohet se kujt do të mund t'i drejtohen me një kërkesë për përmirësimin e gjendjes ose si do të duhej një thirrje për gazetatat. Në vazhdim N i shkruajnë tekstet përkatëse dhe i diskutojnë bashkërisht. Se a do të dërgohen kërkesat vërtet apo do të shërbejnë vetëm si tekste fiktive, duhet të vendoset nga rasti

në rast. Shembuj: kërkesë ose notë proteste presidentit ose parlamentit të vendit të prejardhjes shkaku i një keqpërdorimi / letër ose thirrje një partie që është armiqësore ndaj të huajve ose institucioni në vendin e tanishëm.

6. Letra, e-mail-e, sms, korespondencë me klasat, blog, chat

kl. 2–9



Për shumë mundësi interesante për të hyrë në komunikim autentik me partnerë/e nga gjuha e njëjtë janë dhënë udhëzime tashmë tek nr. 12. «Të shkruhet me adresë referimi». Përpos letrës klasike, përmes mediave e-mail-it dhe sms janë hapur mundësi të reja të komunikimit me shkrim, të cilat mund të përdoren shumë mirë edhe për shkollën. E njëjta gjë vlen edhe për pjesëmarrjen në blog dhe chat, të cilat gjenden në të gjitha gjuhët. Duhet pasur kujdes këtu që N t'i mbajnë fshehur të dhënat personale dhe të rrinë larg nga foret dykuptimshme.

Një variant nxitës për t'u shkruar adresuesve/eve real/e është nëse letra (fiktive), e-mail-i ose sms u shkruhen personaliteteve historike dhe të tjerë ose politikanëve/eve etj. dhe pastaj ato t'u lexohen njërit-tjetrit.

Situata autentike të të shkruarit krijohen edhe nëse N modelojnë kartolina të zbukuruar bukur me dëshirat për ditën e nënave, për vitin e ri ose për një festë nacionale. Një gjë e tillë si kjo situatë për të shkruar, mund të përdoret edhe nga vetë N për të modeluar një ftesë për një mbrëmje me prindër, ose festë kulturore nga mësimi në gjuhën e prejardhjes.

7. Tekste për probleme orientuese

kl. 5–9

45 min.



Të rriturit në, me dhe mes dy kulturave dhe gjuhëve ka anët e mira por edhe të vështira. Je i pasuruar me resurse të dyfishta, por ndoshta je i konfrontuar si në vendin e tanishëm ashtu edhe në atë të prejardhjes me paragjykime dhe rezerva. Ta tematizosh këtë dhe t'i përkrahësh nxënësit/et në orientimin e tyre dhe gjetjen e identitetit, është një detyrë e rëndësishme e mësimi në gjuhën e prejardhjes. Këtu mund të kontribuojnë diskutimet dhe reflektimet me shkrim. Me këtë lidhen situata të të shkruarit si: planifikimi i një rrethi diskutues për çështje të caktuara / Mendimet e mia dhe ndjenjat për çështjen se çfarë përparësish dhe mangësish ka të rritesh në dy gjuhë dhe kultura / Shkëlqyeshëm, und jam dygjuhësor / Si ndihem unë këtu dhe në vendin tim të prejardhjes / etj.

8. Tekste-fantazi, dëshira dhe vizione

kl. 3–9

45 min.



Vendosje e mundshme e temave dhe e çështjeve:

nëse unë do të isha president/e e vendit të prejardhjes (apo të vendit ku jetoj tash) / Si e ëndërojmë jetën time pas 20 vjetësh / Propozimi im për një botë në të cilën të gjithë ndjehen mirë / Problemet, të cilat shpresoj të jenë të tejkaluara pas 50 vjetësh (ose ndoshta edhe pas 50 vjetësh do të jenë ende) / etj.

9. Krahasime gjuhësore

kl. 3–9


45 min.



Krahasime të gjuhës së parë dhe të gjuhës shkollore (p.sh. gjermanisht), por edhe krahasime mes standardit (gjuhës letrare) dhe dialektit në gjuhën e parë janë të mundshme në nivele të kërkesave të ndryshme. Ju i shfrytëzoni në mënyrë ideale kompetencat dygjuhësore të nxënësve/eve të cilat mund të sjellin situata interesante mësimore. Nëse N njohin gjuhë të tjera qoftë nga shkolla ose nga tjetërkund, është e vetëkuptueshme që edhe ato mund të merren për vështrime.

Mundësitë:

- Krahasime dhe grumbullim i fjalëve («macja» në gjuhë të ndryshme; fjalë dialektore për sende të caktuara në gjuhën e parë dhe në gjuhën shkollore, etj.).
- Kërkimi i fjalëve të cilat tingëllojnë njëjtë ose përafërt në të dy gjuhët, por që kanë kuptim diçka krejt tjetër (Shembull: në gjermanisht «Hund» (qen) – në shqip «hundë»; në turqisht «armut» në gjermanisht «Birne» (dardhë).



- Krahasime dhe grumbullime të shprehjeve («mirëdita» në shumë gjuhë; përkthim fjalë për fjalë i shprehjeve si «sa është ora?», «si quhesh ti?»).
- Ekuivalente të fjalëve të urta: cila fjalë e urtë në gjermanisht i përgjigjet një fjale të caktuar të urtë në gjuhën tënde më së shumti?
- Krahasimi i fjalëformimit (si formohen p.sh. shumë fjalë të bashkangjitura të gjermanishtes si dera e shtëpisë, dërrasa e murit, bari i gjelbërt, ngas makinën ...) në gjuhën e parë?
- Krahasimi i ndërtimit të fjalisë në bazë të disa fjalive (lart të shkruhet fjalia në gjuhën e prejardhjes, nën të në gjuhën shkollore; të lidhen me shigjeta ato pjesë që i përkasin një grupi; të provohet në disa fjali, krahasime, përfundime).
- Përkthimi i teksteve të shkurtëra: ku dhe çfarë problemesh dalin, çfarë duhet të jepet ndryshe? (Këtu mund p.sh. nga dy N ta përkthejnë një poezi të shkurtër dhe pastaj të shkëmbejnë mendime mbi përvojat e tyre.)
- Krahasime gjuha standarde – dialekt/e në gjuhën e parë (event. në gjuhën shkollore). përfshirë hulumtimin tek gjyshërit, në internet dhe në libra.

Qëllimi

Nga shumë shkolla dhe mësimdhënës shtjellohen tema ndërkulturore; edhe shumëgjuhësia e klasëve të sotme gjithnjë e më shumë po tematizohet. Këtu krijohen pikënisje optimale për një bashkëpunim mes mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe mësimin të rregullt. Me rëndësi është që edhe mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes të marrin iniciativën. Propozimet vijuese do t'u përshtaten sigurisht edhe kolegëve/leve të mësimin të klasëve të rregullta.

1. Përmbledhje e poezive shumëgjuhësore (njëmbëdhjetëshe etj.)

nga klasa e 2

Info të tjera:
Faqe të ndryshme interneti
për njëmbëdhjetëshet
dhe Haiku

Ky projekt është realizuar në shumë shkolla. N merren me poezitë, sajojnë vetë poezi të thjeshta, i formojnë bukur ato dhe i prezantojnë në formë të një ekspozite apo të një libri. Nëse ekspozita ose libri përmban edhe poezi në gjuhë të tjera (mundësisht me përkthim në gjuhën shkollore), është aq më mirë. Për të sajuar vetë, më së miri është i përshtatshëm «plani ndërtues» i poezive – njëmbëdhjetëshe. Ato ndërtohen nga njëmbëdhjetë fjalë, të cilat ndahen në 5 rreshta të tillë:

i kaltër
ky liqen
shkëlqen plot dritë
unë notoj me qejf
verë

Rrjeshti 1:
1 fjalë (mbiemër, event. emër),
p.sh. një ngjyrë, ndjenjë.

Rrjeshti 2:
2 fjalë (emra me mbaresë)
(çfarë është, për çka flitet ...)

Rrjeshti 3:
3 fjalë (fjalë e shkurtër dëftore)
(çfarë bën?)

Rrjeshti 4:
4 fjalë (fjalë e shkurtër me unë)
(çfarë bën ti?)

Rrjeshti 5:
1 fjalë (mbiemër)
(më e rëndësishmja në një fjalë)

2. Libra të ilustruar shumëgjuhësor

cikli i ulët

ose libra aventurë

cikli i mesëm

Udhëzim për literaturë:
Schader (2012a):
Sprachenvielfalt als Chance,
(Shumëgjuhësia si shansë)
f. 188ff.

Në ciklin e ulët shpesh krijohen libra të ilustruar sipas planit vijues:

- N e lexojnë ose e sajojnë një tregim,
- Ata e ndajnë në episode veç e veç gjegjësisht në ilustrime
- Një ose dy N e vizatojnë një skenë dhe nën të e shkruajnë veprimin përkatës
- Fletët ngjiten ose lidhen bashkë, kështu bëhet një libër i ilustruar i bërë vetë.

Kjo rrjedhë lë pa problem mundësinë për ta zgjeruar në shumëgjuhësi, nëse rreth e rreth ilustrimeve lihet vend, ashtu që p.sh. ilustrimi mund të shkruhet në katër gjuhë. Kështu krijohet një libër i ilustruar shumëgjuhësor, ku mësimi në gjuhën e prejardhjes mund të japë një kontribut të mirë.

Në ciklin e mesëm mund të krijohen libra aventurë «shumëgjuhësor», në të cilët N së pari p.sh. i sajojnë dy personazhe kryesore, të cilët përjetojnë aventura të ndryshme. Nga 1–2 N përshkruajnë pastaj një episod; kur merren së bashku atëherë japin një libër të përgjithshëm aventurë. Do të bëhet shumëgjuhësor, nëse si paracaktim p.sh. merren vesh që episode të veçanta duhet të zhvillohen në vendin e prejardhjes së N dhe në secilin episod duhet të vijë në shprehje disa fjalë të gjuhës së atjeshme (p.sh. «mirëdita», «faleminderit» etj.).

3. Gazeta shumëgjuhësore muri ose e nxënësve/eve

prej klasës së 3/4

Format e ndryshme të gazetave të nxënësve/eve (përfshirë gazetatat e murit dhe si mënyrë e re edhe format elektronike) janë tashmë të dashura që një kohë të gjatë. Ato lënë shumë mirë të zgjerohen në shumëgjuhësi (ashtu si mjaft gazeta të qytetit që kanë rubrika në gjuhët e mëdha të emigrantëve).

Varianti 1: Për temat e gazetës do të integrohen edhe kontribute nga gjuhët e tjera përpos gjuhës shkollore. Këtu do të duhej që së paku teksti të përmbledhet në gjuhën shkollore, në mënyrë që të gjithë të kenë diçka nga kjo.

Varianti 2: Do të krijohen rubrika speciale për lajme në gjuhë të ndryshme (p.sh. në lidhje me ngjarjet në vendet e prejardhjes). Edhe këtu është shumë e dëshirueshme një përmbledhje e shkurtër në gjuhën shkollore.

4. Kontribute për javët e projektit ose ekspozita si «Kulturat tona», «Prej nga vijnë ne», «Vende të mrekullueshme për pushime», «Gjuhët tona» etj.

nga klasa e 4

Nxitja për të bërë një javë projekti ose një projekt me shumë klasa (ose mbrenda klasës), i cili i shfrytëzon resurset shumëkulturore dhe shumëgjuhësore të bashkësisë së nxënësve do të duhej të ketë gjithësi terren të begatshëm në shumë shkolla.

Rreth mundësive të ndryshme për bashkëpunim me mësimin në gjuhën e prejardhjes, llogaritet këtu edhe përkrahja tek përgatitja e referateve ose tek modelimi i pllakateve, fletëpalosjeve ose të reklamave turistike për vende të ndryshme.

Krahaso këtu edhe 10.1 dhe 12.

5. Përmbledhje shumëgjuhësore e recetave

prej klasës së 2/3

Në bashkëpunim me mësimin e rregullt ose të amvisnisë ofrohet kjo ide për të krijuar një përmbledhje të recetave nga traditat në gjuhët e ndryshme të prejardhjes. Kjo mund të ndodhë shumë mirë edhe në dy – gjegjësisht në shumëgjuhësi, ku recetat në gjuhën e parë do të përpunohen në bashkëpunim me mësimin në gjuhën e prejardhjes (ose aty ku kjo mungon, me prindërit). E vetëkuptueshme që të gjitha recetat do të përkthehen në gjuhën shkollore. Një situatë e përbashkët për të zier, eventualisht në kuadër të një feste me prindër ose të një feste të shkollës, e përfundon këtë projekt, i cili do të ishte i përshtatshëm edhe në kuadër të një jave projekti multikulturore.

Qëllimi

Projektet pasuese u ndihmojnë nxënësve/leve në përkrahjen e kreativitetit të tyre. Ato bashkëdyzojnë aktivitetet muzikore dhe gjuhësore dhe çojnë tek produktet atraktive, ashtu që e përkrahin motivimin e tyre në mënyrë plotësuese.

1. Eksperimente me
fluskat gjuhësore

kl. 2–9

15–20 min.



Materiali:
Fotografi të njerëzve nga
gazetat ose revistat.

N zgjedhin një fotografi dhe mendohen se çfarë po mendon ose thotë personi vallë. Për këtë ata bëjnë një fluskë gjuhësore dhe e ngjitin mbi fotografi. Natyrisht mund të modelohen edhe fluska gjuhësore humoristike.



Variante: dialogje-fluska gjuhësore tek fotot me më shumë se dy persona / piktura artistike në vend të fotove (Mona Lisa etj.) Smileys (emocione p.sh. ☹ ose ☺) në vend fotografi /kopje e një vizatimi komik, në të cilin M i ka fshirë fluskat gjuhësore me tippex; të vendoset vetë teksti, të krahasohet.

2. Të bëhet vetë një
vizatim komik

kl. 2–7

30–60 min.



Materiali:
Për 2–4 N një
jastëçkë vule; letër.

M e sqaron rrjedhën: secili ekip dysh mendon së pari një tregim të vogël, i cili do të modelohet si pjesë komike (gjegjësisht tregim ilustrues) në 4–6 ilustrime. Në tregim do të duhej të paraqiteshin dy persona të cilët flasin njëri me tjetrin; këtu mund të paraqitet edhe një kafshë. Në vend që të vizatohen figurat do të stampohen trupat dhe kokat me pulpat e gishtërinjve. Krahët dhe këmbët do të plotësohen pastaj me vija. Kështu ndërtohen shpejt figura humoristike. Teksti do të vendoset në formë të fluskës gjuhësore.

Është mirë nëse paraprakisht janë shikuar tregime ilustruese ose pjesë komike, në mënyrë që N me format e teksteve dhe mundësitë e tyre të kenë më shumë vetëbesim. Shkallë zgjerimi: Krijimi i një fletushke me përmbajtje komike. Kjo është veçanërisht nxitëse, nëse të gjithë N i zgjedhin të njëjtat figura kryesore për fletushkën me përmbajtje komike (dhe si temë p.sh. episode nga vendi i prejardhjes).

3. Romane me fotografi

kl. 6–9

2–3 orë



Materiali:
Fletat, kamera ose telefoni
i dorës me kamerë.

«Romane me fotografi» janë të njohura nga revistat për të rinj. Ato ndërtohen me një tregim me fluska gjuhësore e fotografi. (Ndoshta vijën edhe elemente të tjera të tekstit, p.sh. një brez nën një foto me komentin «Një javë më vonë...».) Afërsisht si tek krijimi i një fletushke me përmbajtje komike, N duhet që së pari të mendojnë një veprim dhe në mënyrë të një skenari ta ndajnë në skena. Fotografitë mund të bëhen (eventualisht në kohën e lirë ose si detyrë shtëpie) me telefon të dorës ose me një kamerë elektronike dhe pastaj të shtypen. N me njohuri të mira të kompjuterit mund të krijojnë tërë romanin me fotografi në mënyrë elektronike.

4. Minibooks

kl. 2–5

30–60 min.



Materiali:
Materiale të paracaktuara
(shiko djathtas)

Minibooks (libra të vegjël) janë libërtha të vegjël të bërë vetë, të cilët përbëhen nga një titull dhe 6–7 faqe tekst. Për krijimin e tyre kërkohet një ide për një tregim, një fletë (A4 ose A3) dhe udhëzimi se si ky duhet të paloset ose prehet.

Udhëzimi gjendet p.sh. në <http://www.minibooks.ch/>. Ose e shkarkon M dhe e shpërndan ose N e bëjnë libërthin e tyre drejtpërdrejt në kompjuter, nëse të tillë janë në shfrytëzim. Libërthat duken atraktivë dhe natyrisht mund edhe të ilustrohen.

5. Rrugët të vazhdohen

klasat 3–9

Materiali:
Pamje të vendit (kartolina ose
fotografi nga revistat).

N marrin një pamje të një treve (p.sh. nga vendi i prejardhjes) dhe e ngjitin mbi një fletë (A4 ose A3 tërthorazi). Ata e ngjyrosin më tutje pamjen e trevës majtas dhe djathtas (eventualisht pjesërisht edhe si detyrë shtëpie). Nën të shkruajnë një tekst për pamjen të cilën ata e përshkruajnë, se si shtegtojnë nëpër këtë trevë dhe çfarë shohin, ndiejnë, nuhatin dhe përjetojnë.

Literatura e përdorur

- AutorInnenteam (2000): Beurteilen und Fördern im Deutschunterricht. Praktische Modelle für individualisierende und fördernde Beurteilungsformen. 3 Bde. Zürich: sabe.
- Autorenteam (2013): Hoppla 4. Deutsch für mehrsprachige Kindergruppen. Zürich/Bern: Schulverlag plus AG/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich.
- Bartnitzky, Horst (2006): Sprachunterricht heute. Berlin: Cornelsen Scriptor.
- Baumann Schenker, Sandra; Karl Ernst (2007): 10 x 10 Spiele für den Sprachunterricht. Zofingen: Erle.
- Bertschinger, Margaretha; Sabine Nötzli-Fellmann (o. J. [1995]): Ich schreibe gerne. Eine Schreibwerkstatt. Zürich: Pestalozzianum
- Böttcher, Ingrid; Michael Becker-Mrotzek (2007): Texte bearbeiten, bewerten und benoten. Berlin: Cornelsen Scriptor.
- Böttcher, Ingrid; Michael Becker-Mrotzek (2012): Schreibkompetenz entwickeln und beurteilen. Praxishandbuch für die Sekundarstufe I und II. Berlin: Cornelsen Scriptor.
- Bredel, Ursula; Hartmut Günther et al. (2006): Didaktik der deutschen Sprache. Paderborn u. a.: Schöningh.
- Büchel, Elsbeth; Ursina Gloor (2009): Sprachland. Sprachlehrmittel für die Mittelstufe. Zürich/Bern: ILZ/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich/Schulverlag blmv AG.
- Büchel, Elsbeth; Dieter Isler (2006): Das Sprachfenster. Lehrmittel für den Sprachunterricht auf der Unterstufe. Zürich: ILZ/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich.
- Diebold, Markus et al. (1985): Lernkontrollen im Deutschunterricht. Zürich: sabe.
- Ernst, Karl (1999): 10 x 10 Textzugänge. Zofingen: Erle.
- Fachbereich Deutsch/Deutsch als Zweitsprache an der PH Zürich/Michael Graf (2007): Schreibdidaktik. Zürich (Typoskript).
- Fachgruppe Deutschdidaktik Primarstufe/Basil Schader (o. J. [2003]): Didaktik des Schreibens. Zürich (Typoskript).
- Fritzsche, Joachim (1993): Schreibwerkstatt. Stuttgart: Klett.
- Glinz, Elly (1997): Wie Kinder Sprache lernen und wie Erwachsene dabei helfen können. Zürich: sabe.
- Glinz, Elly; Hans Glinz (1997): Sprachunterricht. Theorie und Praxis. Zürich: sabe.
- Good, Bruno (1997): Treffpunkt Sprache 4–6. Interkantonales Sprachbuch für die Mittelstufe. Zürich: ILZ/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich.
- Griesshaber, Wilhelm (2008): Schreiben in der Zweitsprache Deutsch. In: Bernt Ahrenholz; Ingelore Oomen-Welke (Hrsg.): Deutsch als Zweitsprache. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren, S. 228–238.
- Keller, Gustav (2011): Lerntechniken von A–Z. Bern: Hans Huber.
- Mayer, Kathrin (2010/2011): Aufsatz- und Schreibformen. Diagnose – Übung – Test. 5. Klasse/6. Klasse. 2 Bde. Augsburg: Brigg Pädagogik.
- Neugebauer, Claudia (2008): Bessere Texte durch gute Schreibaufträge. Link: http://www.netzwerk-sims.ch/wp-content/uploads/2013/08/grundlagen_schreibfoerderung.pdf
- Neugebauer, Claudia; Claudio Nodari (2012): Förderung der Schulsprache in allen Fächern. Praxisvorschläge für Schulen in einem mehrsprachigen Umfeld. Kindergarten bis Sekundarstufe I. Bern: Schulverlag plus.
- Nodari, Claudio (2002): Kontakt. Deutsch für Jugendliche. Zürich: ILZ/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich.
- Nodari, Claudio (2011): Pipapo. Deutsch für mehrsprachige Klassen und Lerngruppen. Aarau/Buchs: Lehrmittelverlag des Kantons Aargau/Lehrmittelverlag des Kantons Zürich/Schulverlag blmv.
- Nodari, Claudio; Claudia Neugebauer (1999): Aspekte der Sprachförderung. In: Mathilde Gyger; Brigitte Heckendorn-Heiniman (Hrsg.) Erfolgreich integriert? Bern: Bernischer Lehrmittel- und Medienverlag, S. 161–175.
- Portmann-Tselikas, Paul R. (1998): Sprachförderung im Unterricht. Handbuch für den Sach- und Sprachunterricht in mehrsprachigen Klassen. Zürich: Orell Füssli Verlag.
- Reinartz-Essers, Dietlind (1980): Zur Didaktik des Schreibens. Frankfurt a. M: Diesterweg.
- Rico, Gabriele (2004): Garantiert schreiben lernen. Sprachliche Kreativität methodisch entwickeln – ein Intensivkurs. Berlin: Rowohlt.
- Schader, Basil (2012a): Sprachenvielfalt als Chance. Das Handbuch. Hintergründe und 101 praktische Vorschläge für den Unterricht in mehrsprachigen Klassen. Zürich: Orell Füssli Verlag.
- Schader, Basil; Barbara Müller (Illu.) (2012b): Mein schlaues Lernheft. Zürich: Orell Füssli Verlag.
- Scherrer, Robert D. (1989): Bilder und Bildergeschichten. Winterthur: Schubi.
- Schweizerisches Gesamtsprachenkonzept (EDK, 1998). Download: http://sprachenkonzept.franz.unibas.ch/Konzept_kurz.html
- Selimi, Naxhi (2010): Wortschatzarbeit konkret. Eine didaktische Ideenbörse für alle Schulstufen. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren.
- Sprachwelt Deutsch. Werkbuch (2012). Überarbeitete Ausgabe. Zürich: Lehrmittelverlag / Schulverlag plus.
- Sturm, Afra; Hansjakob Schneider; Maik Philipp (2013): Schreibförderung an QUIMS-Schulen. Grundlagen und Empfehlungen zur Weiterentwicklung des Programms. Erstellt von der Pädagogischen Hochschule FHNW, Zentrum Lesen, im Auftrag des Volksschulamts der Bildungsdirektion Zürich. Link: <https://wiki.edu-ict.zh.ch/quims/fokusa/hwissen>
- Zopfi, Christa und Emil (1995): Wörter mit Flügeln. Kreatives Schreiben. Bern: Zytglogge.

Vërejtje, përvoja, ide të tjera:

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes (HSU)» përmbledh një radhë të vëllimeve, të cilat kontribuojnë në cilësinë e mësimin në gjuhën e prejardhjes si edhe në lidhjen e saj të mirë me mësimin e rregullt.

Adresantët e kësaj serie janë mësuesit e ardhshëm dhe ata që praktikojnë MGJP-në, si edhe institucionet që përgjigjen për ta në vendet e prejardhjes dhe të emigrimit.

Vëllimi i bazave (doracaku dhe libri i punës. Bazat dhe arsyet) transmetojnë ndër të tjera, pikat më të forta të pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës aktuale në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore.

Vëllimet me nxitje didaktike ofrojnë impulse konkrete dhe planifikime për sfera të ndryshme të mësimin (përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë etj) Të gjitha vëllimet lindën në bashkëpunim të ngushtë me mësues që praktikojnë MGJP-në, kështu që lidhja me praktikën dhe zbatueshmëria konkrete është bashkëmenduar që në krye.

Seria përfshin vëllimet e mëposhtme:



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet në gjermanisht, anglisht, shqip, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, portugalisht dhe turqisht. Ajo do të publikohet nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.